

INSIG JETE sh.a.

**Pasqyrat Financiare Individuale dhe Raporti i Audituesit të Pavarur
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Përmbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA INDIVIDUALE E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSEVE TË PARASË	7
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE	8-53

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Insig Jetë sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Insig Jetë sh.a (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë Insig Jetë sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 kanë qënë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra më 30 prill 2020.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera janë të gjitha informacionet e dhëna në raportin vjetor, përveç pasqyrave financiare, raportit të drejtimit dhe raportit të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

30 prill 2021


mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

Teit Gjini
Auditues Ligjor

INSIG JETE sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivët			
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	9	6,972,021	7,036,696
Depozita me afat	10.1	544,498,838	340,196,316
Letra me vlerë të qeverisë	10.2	-	187,680,006
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi e risigurimi, neto	11	23,500,607	17,115,689
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11.1	1,730,252	16,858,906
Shpenzime të marrjes në sigurim, të shtyra	12	30,380,077	24,893,144
Aktive të risigurimit	13	13,120,615	8,641,241
Aktive të tjera	14	493,620	468,837
Tatime të parapaguara	15	1,246,775	4,964,083
Aktive të shtyra tatimore		48,499	42,279
E drejta e shfrytëzimit të qirase IFRS 16	16	6,404,985	11,594,537
Aktivët afatgjatë jomateriale	17	2,515,047	2,555,912
Aktive të mbajtur për investim	18	437,969,486	4,702,020
Aktivët afatgjatë materiale	16	7,764,398	8,551,116
Shuma e aktiveve		1,076,645,220	635,300,781
Detyrimet			
Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe risigurimi	20	7,958,759	2,638,415
Detyrime të tjera	19	13,929,352	10,183,496
Detyrime për tatim fitimin	32	120,279	-
Detyrimet për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	22	71,818,718	64,754,929
Rezerva për primin e pafiturar	23	116,058,779	116,132,884
Detyrimi ndaj qiramarresit IFRS 16	16	6,739,026	11,711,522
Hua bankare	19.1	182,662,754	-
Qira Financiare	21	-	491,582
Shuma e detyrimeve		399,287,667	205,912,828
Kapitali			
Kapitali themeltar i paguar	24	590,000,000	370,000,000
Rezerve rivleresimi		3,297,097	-
Fitime të pashpërndara		84,060,456	59,387,954
Shuma e kapitalit		677,357,553	429,387,954
Shuma e detyrimeve dhe kapitalit		1,076,645,220	635,300,781

Shënimet shpjeguese nga faqet 8– 53 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INSIG JETE sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	25	199,816,141	225,969,847
Prime të shkruara çeduar risiguruesit	26	(20,402,637)	(16,448,134)
Prime të shkruara neto		179,413,504	209,521,713
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	23	74,105	(11,736,636)
Ndryshimi neto në rezervën e risiguruesit	13	4,479,374	(974,460)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		183,966,983	196,810,617
Të ardhura nga investimet	27	10,272,797	8,308,103
Shpenzime financiare	27	(501,937)	(782,482)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	27	713,450	(504,501)
Të ardhura të tjera operative	31	4,774,865	3,325,877
Totali i të ardhurave te tjera		15,259,175	10,346,997
Ndryshimi neto në rezerva të dëmeve	22	(7,063,789)	(10,386,593)
Dëme të ndodhura të sigurimit	22.1	(55,603,496)	(61,296,085)
Dëme të paguara nga risiguruesi	22.2	-	1,155,997
Ndryshimi neto në shpenzime të shtyra	12	5,486,932	1,540,912
Kostot e marrjes në sigurim	28	(54,231,780)	(54,897,127)
Shpenzime personeli	29	(32,452,783)	(33,795,578)
Shpenzime administrative	30	(21,348,435)	(14,183,869)
Amortizimi	16_16.1	(7,046,935)	(6,825,498)
Totali i shpenzimeve		(172,260,286)	(178,687,841)
Fitimi para tatimit		26,965,872	28,469,773
Tatimi mbi fitimin	32	(4,609,158)	(4,353,724)
Fitimi i periudhes		22,356,714	24,116,049
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		3,297,097	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhen		25,653,811	24,116,049

Shënimet shpjeguese nga faqet 8– 53 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INSIG JETE sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumtat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Fluksit të Parasë për periudhën deri më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fluksi i parasë nga aktivitete operative		
<i>(Humbja)/Fitimi para tatimit</i>	26,965,872	28,469,773
Rregullime për:		
Amortizimin	7,046,935	6,825,498
Fitim/ humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme	2,668,673	-
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	(74,105)	11,736,636
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit	(4,479,374)	974,460
Ndryshimi në neto në rezerva të tjera	7,063,789	10,386,593
Ndryshim ne aktiv te shtyre tatimor	-	(42,279)
Zhvlerësim për borxhin e keq	233,681	-
Humbje nga kursi i këmbimit	(3,426,651)	504,501
Shpenzime per interesin	501,937	782,482
Të ardhura nga interesi	(10,272,797)	(8,308,103)
Fluksi i parasë përpara ndryshimeve në aktive dhe detyrime	26,227,960	51,329,561
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:		
Ndryshime në shpenzime të marrjes ne sigurim, te shtyra	(5,486,933)	(1,540,913)
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe risigurimit	(6,695,313)	1,981,418
Ndryshimi në aktivet e tjera	956,097	202,174
Ndryshime ne tatime te parapaguara	857,104	(2,539,577)
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe risigurimit	5,320,344	(1,895,536)
Ndryshimi në detyrime ndaj qirase financiare	(6,126,414)	(5,979,463)
Ndryshimi në detyrime të tjera	3,745,856	(1,494,170)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme me palët e lidhura	14,894,973	133,678
Interesi i arkëtuar	9,348,975	5,095,679
Interes i paguar	(15,193)	(61,119)
Tatim fitim I paguar	(1,634,895)	(7,565,302)
Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet	15,164,601	(13,663,131)
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve jomateriale	(489,925)	(545,409)
Blerja e aktiveve të trupezuara	(225,663)	-
Te ardhura nga shitja e asetëve	2,630,000	-
Ndryshim ne aktive te mbajtura per investim	(433,267,466)	-
Ndryshimi ne depozita me afat	(200,698,185)	(37,195,592)
Letra me vlere te maturuara	187,680,006	190,372,389
Blerje letre me vlere	-	(189,627,610)
Ndryshimi ne detyrime ndaj institucioneve financiare	182,662,754	-
Flukset monetare për aktivitetet investuese	(261,708,479)	(36,996,222)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Emetimi i kapitalit	220,000,000	-
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese	220,000,000	-
Rritje/(Rënie) neto për mjetet monetare dhe ekuivalente	(315,918)	670,208
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	7,036,696	6,533,328
Efekti i ndryshimit te kursit te kembimit	251,243	(166,840)
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit	9 6,972,021	7,036,696

Shënimet shpjeguese nga faqet 8– 53 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INSIG JETE sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)


PASQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL

më 31 dhjetor 2020


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva nga rivleresimi	Fitimet e Pashpërndara	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	370,000,000	-	35,271,905	405,271,905
Fitimi i periudhes	-	-	24,116,049	24,116,049
Gjendja më 31 dhjetor 2019	370,000,000	-	59,387,954	429,387,954
Fitimi i periudhes	-	-	22,356,714	22,356,714
Rimarrje e rezervës së rivlerësimit	-	(2,315,788)	2,315,788	-
Rezerva nga rivleresimi I asetëve	-	5,612,885	-	5,612,885
Rritje në kapitalin e paguar	220,000,000	-	-	220,000,000
Gjendja më 31 dhjetor 2020	590,000,000	3,297,097	84,060,456	677,357,553

Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga Drejtori Ekzekutive më 30 Prill 2021 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Drejtor Ekzekutive



Drejtor e Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit



Shënimet shpjeguese nga faqet 8- 53 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiar

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria e sigurimeve INSIG JETË sh.a është rrjedhojë e shoqërisë së sigurimit INSIG sh.a, themeluar me ligjin nr. 7506, datë 31 korrik 1991 "Për Institutin e Sigurimeve". INSIG sh.a. ishte institucioni i parë dhe i vetëm shtetëror për të ushtruar aktivitetin e sigurimit dhe risigurimit në RSH.

INSIG sh.a. ushtronte aktivitetin e sigurimeve në të dyja klasat e sigurimit të jetës dhe jo-jetës deri në vitin 2016, vit që solli privatizimin e saj nga shoqëria e sigurimit "EUROSIG" sh.a, në cilësi të aksionarit të vetëm dhe zotërues i 100% aksioneve të tij. Me privatizimin, INSIG sh.a. filluan procedurat ligjore për të përshtatur veprimtarinë e saj të ndarë për jetën dhe jo – jetën.

Vendimi i Bordit të AMF nr. 202, datë 27.12.2016 miraton ndarjen e shoqërisë INSIG sh.a. në dy shoqëri INSIG sh.a. dhe INSIG JETE sh.a me të njëjtin aksionar të vetëm, shoqëria e sigurimit "EUROSIG" sh.a.

INSIG JETË sh.a krijohet si Shoqëri siguri me NUIS: L71325020H dhe filloi aktivitetin e saj tregtar në klasat e sigurimit të jetës gjatë vitit 2017 në përputhje të plote me termat dhe klasat e përcaktuara në ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe sipas Licences nr. 4/2000, datë 27.12.2016.

Me vendimin nr. 53, datë 22.05.2017 "Për miratimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e sigurimit "INSIG JETË" sh.a. të Bordit të AMF, ndryshon struktura e zoterimit të aksioneve sipas të dhenave që paraqiten tek shenimi 23.

Shoqëria ka transferuar të gjitha aktivitetet dhe detyrimet nga INSIG sh.a në datën 1 janar 2017, datë në të cilën ka filluar edhe aktiviteti i kësaj Shoqërie.

Ndryshimi i strukturës së aksioneve, u shoqërua edhe me ndryshimin e organizimit në drejtimin e shoqërisë. INSIG JETE sh.a është e organizuar dhe funksionon si një Shoqëri tregtare me një sistem dhe një nivel drejtimi, Keshill Administrimi.

Më 26 maj 2020 është firmosur marrëveshja për revokimin e kontratës së shitjes së aksioneve të Insig Jetes date 10.05.2017.

AMF me anë të vendimit numër 117 të Bordit, datë 31.08.2020, vendosi miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën:

- 100% të aksionari Shoqëria jo - jetë "EUROSIG" sh.a. në shoqërinë e sigurimit të Jetës "Insig Jetë" sh.a..

Anetarët e Keshillit të Administrimit janë:

- Vaso Pilo – Kryetar
- Anila Ibraj – Anetar
- Forcim Kola – Anetar

INSIG JETE sh.a ushtron aktivitetin e saj tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet zyrave qendrore të saj me adrese: Rruga e Labinotit; Nr. 77, Tirane, si dhe degëve të saj në rrethe, respektivisht: Tirane, Shkoder, Fier, Elbasan, Vlore, Korce dhe Sarande.

Më 31 dhjetor 2020, INSIG JETE sh.a ka 27 punonjes (2019: 28 punonjes).

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në përputhshmëri me kërkesat rregulatore.

b) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Lekë, që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve ku specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lekë.

d) Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimin profesional

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohet se janë të përshtatshëm dhe relevant për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

Pretendimet dhe përfitimet e policë-mbajtësit

Vlerësimi i detyrimeve që lindin nga dëmet të ndodhura nga kontratat e sigurimeve është vlerësimi kontabël më kritik i Shoqërisë. Vendimi i Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të paraportuara dhe vendosja e rezervës dhe rimarrjave të sigurimit, rishikohen dhe përditësohen çdo vit, dhe ndryshime që rezultojnë nga ky vlerësim pasqyrohen në humbjet ose fitimet. Procesi nuk mbështetet në supozimin që eksperiencat e mëparshme të rregullara për efektet e zhvillimeve dhe trendave aktualë, është një bazë e besueshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme.

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera njihen me kosto duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i zbritjeve për humbjet nga zhvlerësimi është gjithashtu një vlerësim kritik i realizuar nga drejtimi. Në çdo datë raportimi bëhet një vlerësim nëse llogaritë e arkëtueshme të sigurimit duhet të zhvlerësohen. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit të cilat kanë indikatorë për zhvlerësim zhvlerësohen, me përjashtim nëse ka një probabilitet të lartë që do të arkëtohen. Ky probabilitet ekziston nëse Shoqëria ka marrëdhënie afatgjata me klientët ose kur Shoqëria blen të mira dhe shërbime nga i siguruari dhe të arkëtueshmet përcaktohen si shumë neto. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me vonesë më pak se një vit vlerësohen individualisht në rastet kur ato kanë vlerë të konsiderueshme dhe zhvlerësohen plotësisht nëse ekzistojnë informacione që nuk do të mblidhen. Llogaritë e arkëtueshme me vonesë më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në grup duke u bazuar në vjetërsinë e tyre. Përqindja e provigjonit që aplikohet për çdo kategori vjetërsie të llogarive të arkëtueshme me vonesë më pak se një vit përfaqëson vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi humbjet e ardhshme dhe bazohen mbi eksperiencat e rimarrjes së viteve të mëparshme dhe të eksperiencave të tregut.

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

d) Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional (vazhdim)

Për kontratat e sigurimit të jetës, vlerësimet bëhen si për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të raportuara në deklaratën e datës së gjendjes financiare dhe për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të ndodhura por jo të raportuara ende në Deklaratën e datës së pozicionit financiar ("IBNR"). Kostoja përfundimtare e kërkesave të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të kërkesave të teknikave standarde të projektimit.

Supozimi kryesor në themel për këto teknika është se për një kompani pretendimet e kaluara si përvojë zhvillimi mund të përdoren për projektin e zhvillimit të kërkesave të ardhshme dhe kostot përfundimtare. Si të tilla, këto metoda nxjerrin zhvillimin e paguar dhe humbjet e shkaktuara, shpenzimet mesatare për kërkesë dhe numrat e kërkesave të bazuar në zhvillimin e vërejtur vitet e mëparshme dhe raportet për humbje që priten.

Zhvillimi historik dhe pretendimet historike është analizuar kryesisht nga vitet e aksidentit, por mund edhe të analizohen më tej nga zona gjeografike, si dhe nga linja të rëndësishme të biznesit dhe llojet e kërkesave.

Gjykimi cilësor shtesë është përdorur për të vlerësuar shkallën në të cilën tendencat e kaluara nuk mund të zbatohen në të ardhmen, në mënyrë që të arrijë në koston e vlerësuar përfundimtare të kërkesave që paraqesin rezultatin e mundshëm nga rangun e rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasigurive të përfshira.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare individuale sipas parimit të vijimësisë. Në krijimin e këtij gjykimi, drejtimi ka kryer një analizë të detajuar duke konsideruar të gjitha faktet dhe rrethanat e mundshme si dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, treguesit ligjore, likuiditetin, pozicionin në treg dhe vendimet strategjike të investimit.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në përputhje me të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar me konsistencë nga Shoqëria.

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja që vjen nga këmbimet valutore për këto transaksione dhe nga këmbimet me kursin e fundvitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
USD	100.84	108.64
EUR	123.70	121.77

b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve

Kontratat e sigurimit janë ato kontrata nën të cilat Shoqëria ka pranuar rrezik të rëndësishëm sigurimi nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon policë-mbajtësin. Shoqëria përcakton nëse ka rrezik të rëndësishëm sigurimi, duke krahasuar përfitimet që duhet të paguhet pas një ngjarjeje të siguruar me përfitime të pagueshme nëse ngjarja e siguruar nuk ndodh. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë gjithashtu rrezik financiar.

Kontratat e investimit janë ato kontrata që transferojnë rrezik të rëndësishëm financiar, por jo rrezik të rëndësishëm sigurimi. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë variable të ndryshme (si norma interesit, çmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, ose variabla të tjerë) me kushtin që në rastin e variablave jo-financiar variabli të mos jete specifik për një prej palëve në kontratë.

Pasi një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetës së saj, edhe nëse rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose skadojnë. Megjithatë, kontratat e investimit mund të riklasifikohen si kontrata sigurimi pas krijimit nëse rreziku i sigurimit bëhet i rëndësishëm.

c) Njohja dhe matja e kontratave***Primet******Primet për sigurimin e jetës - afatshkurtra***

Primet e shkruara bruto përfshijnë shumat e përfituara nga polica ose kontrata sigurimi të lidhura gjatë vitit financiar në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nga fakti se shuma të tilla mund të lidhen tërësisht apo pjesërisht me një periudhë të mëvonshme në kontabilitet. Primet paraqiten bruto përfshirë komisionet e ndërmjetësve dhe taksat e bazuara në prime. Pjesa e fituar e primeve të pranuar njihet si e ardhur. Primet janë të fituara nga data e marrjes përsiper të rrezikut, përgjatë periudhës së sigurimit, bazuar në modelin e rrezikut të nënshkruar.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

c) Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

Primet (vazhdim)

Primet për sigurimin e jetës - afatgjata

Për kontratat e sigurimit që kontrahohen me debitorë të Bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, dhe që kanë afat disa vjeçar, për mbulimin e kredisë gjatë afatit të shlyerjes së saj, Shoqëria njihet në të ardhura primin e shkruar bruto vjetor në momentin që lëshon kontratën e sigurimit.

Per kontratat afatgjata për të cilat Shoqëria arkëton primin në total për të gjithë afatin e kontrates, pjesa e mbetur e kontratës afatgjatë të sigurimit me debitorët, që nuk është njohur në periudhën raportuese pasqyrohet si angazhim i Shoqërisë për vitet e ardhshme.

Rezerva për primin e pafituar

Primet e pafituara përfshijnë atë pjesë të primeve të shkruara bruto, me periudhat e rrezikut pas datës së raportimit. Primet e marra janë llogaritur në baza ditore pro rata. Primi i pafituar llogaritet nga prime të shkruara bruto, dhe shtyhet për tu njohur në periudhat pasardhëse si rezerva për primet e pafituara.

Për llogaritjen e rezerves së primit të pafituar janë marrë në konsideratë kontratat e shitura për të gjitha linjat e biznesit të jetes. Në llogaritjen e rezerves së primit të pafituar është përdorur metoda e diteve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit dhe nuk janë konsideruar në llogaritjet për rezervën e primit të pafituar policat e kthyera apo anuluarat, me përjashtim të produktit të Jetes së Debitorit, për të cilin rezerva e primit është llogaritur me metodat aktuariale për provigjionet matematike, duke marrë në konsideratë vlerën e pamaturuar të ekspozimit të kredise si dhe tabelat e mortalitetit për cdo moshe.

Primet e risigurimit

Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë nga risiguruesi. Nëse një policë sigurimi anulohet, primi i mbetur për t'u paguar përfshihet në të ardhurat nga primet. Lëvizja e detyrimeve nga sigurimi, nëse ka ndonjë, njihet si e ardhur neto e pjesës së risiguruesit.

Shoqëria është e mbuluar me risigurim në portofolet e sigurimit Jete Debitori me marrveshje risigurimi, nderkohe që ka patur dhe një numër të kufizuar kontratash për të cilat është kërkuar risigurim fakultativ (ose bashkesigurim), për produktin jete debitori dhe jete në grup me aksidente personale.

Të ardhura nga investimet

Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë dhe depozitat njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, në masën proporcionale që i takon periudhës raportuese dhe llogariten duke përdorur metodën e Normës Efektive të Interesit (NEI). Tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e yield-it efektiv të aktivitetit financiar njihen si një rregullim në NEI të instrumentit.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të krijuara gjatë periudhës financiare që rrjedhin nga blerja ose ripërtëritja e kontratave të sigurimit, shtyhen deri në masën që këto kosto janë të rikuperueshme nga primet e ardhshme nga kontrata e sigurimit.

Të gjitha shpenzimet e tjera të blerjes njihen si shpenzime kur ndodhin.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim dhe të ardhurat e shtyra nga komisionet përfaqësojnë përqindjen e kostove të ndodhura të marrjes në sigurim dhe të ardhurave që korespondojnë me rezervën e primit të pafituar. Të ardhurat shtyhen dhe njihen si të ardhura kur shërbimet përkatëse do ofrohen dhe njihen në pasqyrën e fitimit humbjes së vitit.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

c) Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

Dëmet

Dëmet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës

Dëmet përbehen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në rezervën për dëmet pezull. Dëmet bruto të paguara përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra për këto dëme. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

Rezerva për dëmet

Rezerva për dëmet janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe atij të mëparshme të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal. (shenimi a)). Rezerva përfshin edhe dëmet e ndodhura, por të paraportuara (IBNR) në atë datë (shenimi b)).

a) Rezerva per dëmet – RBNS: Per perlllogaritjen e rezerves se demeve eshte perdorur metoda “Rast pas Rasti” mbeshtetur ne vleren e rezerves te llogaritur nga specialisti i demeve. Kjo metode eshte perdorur tek te gjithë portofolet.

b) Rezerva per dëmet – IBNR: Per llogaritjen e IBNR-se per produktet e sigurimit te jetes ne kushtet e numrit te ulet te demeve ne cdo portofol, eshte i pamundur perdorimi i metodes se trekendeshave, per kete arsye ne llogaritjen e saj eshte marre ne konsiderate Raporti i Humbjeve per te pakten 3 vitet e fundit te aktivitetit mbi Primin e fituar te periudhave respektivedhe me nje vlere te maksimizuar te raporteve dhe eshte vleresuar raporti i mundshem i humbjeve te periudhes duke percaktuar keshtu Ultimate Rezerve per cdo portofol.

Eshte bere analiza e raportit IBNR faktike per cdo nje vit nga periudha ne analize dhe ky eshte optimizuar dhe aplikuar mbi Ultimate rezerve per cdo produkt duke percaktuar keshtu nivelin e IBNR. Nderkohe qe analiza e testeve run-off, ka rezultuar pozitive per te tera produktet.

Nderkohe qe ne portofolin e sigurimit te jetes se Debitorit, ku te dhenat ne vite dhe numri I demeve na e lejojne, eshte aplikuar metoda klasike e IBNR me ane te trekendeshit te zhvillimit te demeve.

Risigurimi

Shoqëria cedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllim që të limitojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Shoqërisë detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto.

Kontratat nga të cilat lind një transferim i rrezikut të sigurimit kontabilizohen si sigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin.

Aktivitet e risiguara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguroese për detyrimet e primeve të ceduara si dhe shuma të rikuperueshme nga dëmet e paguara. Këto shuma, nëse ka të tilla, klasifikohen si shuma të arkëtueshme dhe paraqiten në pasqyrat financiare.

Llogarite e arketueshme nga kontratat e risigurimit përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguroesit dhe te arketueshmet nga shoqeria risiguroese ne perputhje me demin e paguar. Keto klasifikohen si llogari te arketueshme dhe paraqiten te vecanta. Aktivitet e risigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Shoqëria nuk mund të rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe për një ngjarje e cila ka një impakt të matur në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Shoqëria do të marrë nga risiguroesi.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

c) Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

Dëmet (vazhdim)

Testi i mjaftueshmërisë së rezervës

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen një test të mjaftueshmërisë së rezervës së dëmeve i cili i jep Shoqërisë një vlerësim nëse detyrimet e sigurimit të cilat janë njohur janë të mjaftueshme. Testimet kryesore të kryera përfshijnë “Analizën e Raportit të Dëmeve” dhe “Analizën e Zhvillimit të Provigjioneve të Dëmeve”.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht për të gjitha produktet kryesore të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet, si dhe mbi dëmet duke përfshirë kostot e marrjes në sigurim dhe kosto të tjetër të jashtme të lidhura me dëmin. Për të kryer këtë analizë, Shoqëria merr parasysh parashikimet për daljet e flukseve të parasë. Shoqëria nuk i skonton këto flukse parash të parashikuara sepse shumica e dëmeve priten të paguhen brenda vitit, ndërkohë 35% e rezervave të dëmeve lidhet me dëme të refuzuara për të cilat ka pasiguri të arsyeshme për mos pagimin e tyre.

Gjithashtu, Shoqëria kryen Analizën e Zhvillimit të Provigjioneve të Dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj të përcaktimit të rezervave. Kjo analizë kryhet në mënyrë të veçantë, por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara, por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura, por të paraportuara). Nëse analiza nxjerr në pah mospërputhje të mëdha, Shoqëria kryen rregullime në metodologjinë e përdorur. Nëse identifikohet një mangësi ajo ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provigjion për riskun e paskaduar nga humbjet që rrjedhin nga testi i mjaftueshmërisë së rezervës.

d) Instrumentet financiare

Ashtu si shpjegohet në shenimin 3(u), Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë IFRS 9 Instrumentat Financiare në datën e hyrjes në fuqi të SNRF 17 që pritet të zbatohet më 1 janar 2021, ashtu siç lejohet për kompanitë e sigurimeve, dhe instrumentat financiarë njihen dhe maten në bazë të IAS 39.

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh investimet dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3(f), (g) dhe (h).

(iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktiviteti financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anulohen ose maturohen.

(iv) Netimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga Standartet e Kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

d) Instrumentet financiare (vazhdim)

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet financiare të tjera vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit është me metoden e aktualizimit të flukseve të ardhshme monetare të instrumentit.

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënie në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënie në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë, por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohet të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidencë objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

e) Mjetet monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

f) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi llogaritet në menyre proporcionale me periudhën perkatese dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

g) Letrat me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe rregjistrohen si të ardhura nga interesi.

h) Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë llogaritë e arkëtueshme nga të siguruarit dhe njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar humbjet më pak nga rënia në vlerë.

i) Llogaritë e pagueshme nga sigurimet dhe të pagueshmet e tjera

Llogaritë e pagueshme nga sigurimi dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve të lidhura drejtpërdrejtë me të.

j) Aktive afatgjata të investimit

Aktiv afatgjatë të investimit mbahen për të siguruar të ardhura nga qiraja ose për rritje të vlerës së kapitalit ose të dyja së bashku. Prandaj, një aktiv afatgjatë material i investuar gjeneron flukse mjetesh monetare në mënyrë tërësisht të pavarur nga aktivet e tjera të mbajtura nga njësi ekonomike.

Shoqëria, ka aktiv afatgjatë të investuar që perbehet nga toka e mbajtur për përdorim në të ardhmen aktualisht të papërcaktuar. Shoqëria nuk e ka përcaktuar nese do ta përdorë tokën si pasuri e zotëruar nga pronari ose për shitje afatshkurtër në rrjedhën normale të biznesit, atëherë toka trajtohet si e mbajtur për rritjen e vlerës së kapitalit.

Njohja dhe matja

Ne momentin e njohjes aktivet afatgjata materiale të mbajtura për investim maten me koston e tyre. Kostoja e aktivitet afatgjatë përfshin cmimin e blerjes dhe të gjitha shpenzimet e ngarkueshme drejtpërdrejtë si tarifatat ligjore dhe të ndermjetesimit, taksat e transferimit të pasurisë dhe kostot e tjera të transaksionit.

Vlerësimi i mëpasshëm

Te gjitha aktivet e mbajtura si investim si toke, ndertese, makineri dhe pajisje, për të cilat vlera e drejte nuk është e disponueshme në datën e raportimit janë mbajtur duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim.

Transferimet

Nese vlera e drejte për një ze të aktivitet afatgjatë të investuar që matet duke përdorur modelin e vlerës së drejte, nuk është e disponueshme pa kosto ose perpjekje të panevojshme, shoqëria do ta trajtojë këtë ze si toke, ndertese, makineri dhe pajisje deri sa vlera e drejte të bëhet e disponueshme. Vlera kontabel e aktivitet afatgjatë të investuar në këtë datë bëhet kosto e tij. Ky është një ndryshim i rrethanave dhe jo një ndryshim në politiken kontabel.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**k) Ndërtesa dhe pajisje***i. Njohja dhe matja*

Zërat e ndërtesës dhe pajisjeve maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë, dhe kostot e rregullimit të vendit në të cilin ato do të vendosen.

Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe pajisjeve.

ii. Kostot e mëvonshme

Në vlerën e mbartur të një njësie të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara Shoqëria njeh kostot e zëvendësimit të një pjese të kësaj njësie kur ka ndodhur kjo kosto, në qoftë se është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara tek njësitë t'i shkojnë Shoqërisë dhe kostoja e njësisë të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim në momentin kur ato ndodhin.

l) Aktive afatgjata të investimit*iii. Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur. Aktivitetet e marra me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

Ndërtesa	5 %
Makineri dhe pajisje zyre	20 %
Pajisje informatike	25 %
Mjete transporti	20 %

Aktivitetet mund të rivlerësohen duke iu referuar të dhënave të vëzhguara duke rregulluar shumën bruto kontabël të aktivitetit sipas vlerës së tregut ose me përcaktimin e vlerës së tregut të vlerës kontabël dhe rregullimin e vlerës kontabël bruto në mënyrë proporcionale, në mënyrë që rezultojnë që vlera kontabël të jetë e barabartë me vlerën e tregut. Përveç kësaj, amortizimi i akumuluar apo amortizimi është diferenca e shumave bruto me ato neto të aktivitetit. Gjate periudhës aktuale shoqëria ka kryer rivlerësime të ndërtesave, kështu ka ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

m) Aktive jo-materiale

Aktivitetet jo-materiale të Shoqërisë të ndryshme nga emri i mirë kanë jetë të dobishme të caktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe licencat. Licencat e programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të shpenzimeve të bëra për t'i marrë dhe vënë në përdorim.

Kostot e zhvillimit që lidhen direkt me programe të identifikueshme dhe unike që kontrollohen nga Shoqëria regjistrohen si aktive jo-materiale nëse rrjedhja e përfitimeve ekonomike në rritje i tejkalon kostot. Kostot e kapitalizuara përfshijnë shpenzimet e stafit të zhvillimit të programeve kompjuterike dhe një pjesë përkatëse të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programe kompjuterike, p.sh. mirëmbajtja e saj, janë shpenzuar kur ndodhin. Aktivitetet jo-materiale amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme prej 7 vjet.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

n) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë të aktivitetit. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera kontabël zhvlerësohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet atëherë kur vlera e mbartur e një aktivi ose njësisë e tij e gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

Njësi gjeneruese e mjeteve monetare është njësi më e vogël e identifikueshme e grupimit të aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një mjeti ose një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e lartë midis vlerës së përdorimit dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përafrimin e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës që reflekton vlerësime të krahasueshme me tregun të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqeve që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë rimerret vetëm deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit e cila nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk do të kishte qënë humbje nga zhvlerësimi i njohur.

o) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet në vlerë nominale të aksioneve të emetuara. Kostot e jashtme shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të këtyre aksioneve njihen në kapitalin neto, neto nga tatimi. Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të jenë autorizuar për t'u deklaruar, paraqiten në shënimin e ngjarjeve pas periudhës raportuese. Dividentët e përkohshëm zbriten nga kapitali kur ato deklarohen dhe paguhen.

p) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 3.d).

q) Shpenzimet e marrjes në sigurim dhe trajtimit të dëmeve

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë edhe kostot direkte, të tilla si komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të marketingut që lidhen me procesin e propozimit dhe emetimit të policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen si shpenzime kur lindin.

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzimet brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Kostot direkte të marrjes në sigurim shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policës përmes një metode konsistente me llogaritjen e provizionit të primit të pafituar dhe paraqiten bruto nga detyrimi përkatës i sigurimit, si një aktiv. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim amortizohen sistematikisht përgjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk rimerret konsiderohet shpenzim.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

r) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet

Shoqëria paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që u sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Autoritetet respektive të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni legal kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin e minimumit legal të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ato lindin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumë të pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar. Për vitin 2020 punonjësit e shoqërisë i kanë përfunduar lejet e tyre vjetore.

s) Qiratë SNRF 16

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira ose mbajtje qiraje, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkohet një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi specifik ose nëse angazhimi përcjell një të drejtë për përdorimin e një aktivi. Qiratë të cilat nuk i transferojnë Shoqërisë të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e sendeve të marra me qira janë qira operative. Të pagueshmet nga këto qira njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Të gjitha qiradhënjet pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të fitojë një të drejtë përdorimi të një aktivi në fillim të qerasë, dhe nëse pagesat e qerasë bëhen me kalimin e kohës, edhe marrja e financimit. Sipas SNRF 16, eliminon klasifikimin e qirasë si qera operationale ose qera financiare sic kërkohet në SNK 17 dhe, në vend të saj prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit do të kërkohet të njohin: (a) aktive dhe detyrime për të gjitha qeratë me afat me shumë se 12 muaj, vetëm nëse aktivi ka vlerë më të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të qerasë të ndarë nga interesi i detyrimit të qerasë në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 trajton në të njëjtën mënyrë kontabël rastin e qiradhënesit si në SNK17.

Kompania ka aplikuar qasjen e thjeshtuar të tranzicionit dhe nuk ka riparuar informacion krahasues, sic lejohet në parashikimet e vecanta të tranzicionit në standard. Kompania e njeh detyrimin e qerasë në lidhje me qeranë që ka qenë fillimisht klasifikuar si “qera operationale” sipas parimeve të SNK 17 Qeratë.

Norma e interesit e huamarrjes e aplikuar në detyrimet e qerasë më 1 janar 2020 ishte në përputhje me normat e Bankës së Shqipërisë.

Shoqëria vlerëson në fazën fillestare të lidhjes së një kontrate, nëse kontrata është, ose përmban një qira. Kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume.

Shoqëria aplikon një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Shoqëria njeh detyrimet ndaj qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe të drejtën e përdorimit të aktiveve, e cila paraqet të drejtën për ta përdorur aktivin.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**s) Qiratë SNRF 16 (vazhdim)****E drejta e përdorimit të aktivit**

Shoqëria njih të drejtën e përdorimit të aktivit në datën e fillimit të kontratës së qirasë. E drejta e përdorimit të aktivit matet me kosto, më pak se zhvlerësimi ose humbja nga zhvlerësimi dhe e rregulluar për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë. Kjo kosto përfshin shumën e detyrimeve të njohura të qirasë, kostot fillestare direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, pakësuar me çdo pagesë të marrë si nxitës. E drejta e përdorimit të aktiveve zhvlerësohet në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë. Të drejtat e përdorimit të aktiveve paraqiten në Shënimin 14 “Ndërtesa, pajisje, të drejta përdorimi të aktiveve dhe aktivet e patrupëzuara”.

t) Detyrimet për qira

Në datën e fillimit të kontratës, Shoqëria njih detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse (pakësuar me çdo pagesë stimuluese të arkëtueshme), pagesat variabël të qirasë, të cilat varen nga një indeks ose normë,

Qiratë SNRF 16

dhe shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancive. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e blerjes të parashikuar në rastin kur ka arsye që Shoqëria të ushtrojë opsionin e blerjes si dhe penalitetet që shoqërojnë mbarimin e qirasë në rastin kur është ushtruar opsioni i mbylljes para kohe. Pagesat e kryera për qiratë operative njihen në fitim/humbje në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë. Vlerat e marra si stimuj nxitës të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve të qirasë, përgjatë afatit të qirasë.

Aktive**LEK**

Angazhime për qira operacionle më 31 dhjetor 2019	12,713,190
Norma rritëse e huamarrjes mesatare më 1 janar 2020	5.16%
Angazhime të rregulluara të qirasë operacionale më 1 janar 2020	16,806,155

Pakësuar:

Angazhime të lidhura me qira afatshkurtra	400,000
Angazhime të lidhura me qira për aktive me vlerë të vogël	616,477

Shtuar:

Pagesa qiraje të lidhura me periudhë rinovimi jo të përfshira në angazhimet për qira operacionale më 31 dhjetor 2019	200,000
--	---------

Detyrime për qira më 1 janar 2020**15,989,678****u) Tatimi**

Tatimi mbi fitimin apo humbja për vitin pëfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke axhustuar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga Ligji Shqiptar.

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohëshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdoruar për qëllim tatimor. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohëshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose në fuqi në mënyrë të konsiderueshme në datën e raportimit. Jë aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoret. Tatimi i shtyrë rishikohet çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën sa nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

v) Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë aplikuar ende

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 4 Kontratat e sigurimit – Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Amendimet adresojnë çështjet që lidhen me implementimin e standardit të ri mbi instrumentat financiare, SNRF 9-ën, përpara implementimit të standardit të ri për kontratat e sigurimit që Bordi është duke shqyrtuar dhe që do të zëvendësojë SNRF 4-ën. Këto amendime paraqesin dy opsione për

Përrjashtim i përkohshëm i SNRF 9

shoqëritë që u lëshojnë kontrata sigurimi klientëve: përrjashtimin e përkohshëm nga aplikimi i SNRF 9-ës dhe metodën e mbivendosjes. Shoqëritë të cilat kanë predominancë në aktivitetin e tyre të sigurimit, kanë mundësinë të zgjedhin moszbatimin e SNRF 9-ës. Ky përrjashtim i lejon keto shoqëri të vazhdojnë aplikimin e SNK 39-ës Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja, ndërkohë që shtyjnë aplikimin e SNRF 9-ës të paktën, deri në 1 janar 2021. Predominanca do duhet të vlerësohet fillimisht në periudhën raportuese që vjen menjëherë pas datës 1 prill 2016 dhe përpara datës së implementimit të SNRF 9-ës. Rivlerësimi i predominancës në periudha të mëpasshme mund të kryhet vetëm në raste të rralla. Shoqëritë që aplikojnë përrjashtimin e përkohshëm do duhet të japin shënime shpjeguese të tjera në pasqyrat e tyre financiare.

Metoda e mbivendosjes

Metoda e mbivendosjes është një mundësi për shoqëritë që do adoptojnë SNRF 9 dhe lëshojnë kontrata sigurimi, të sistemojnë pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për aktive financiare të lejueshme; të cilat efektivisht rezultojnë me aplikim të SNK 39-ës. Ky sistemim eliminon luhatjen në veprimet kontabël që lindin prej aplikimit të SNRF 9-ës përpara aplikimit të standardit të ri të kontratave të sigurimit.

Sipas kësaj metode, një shoqëri lejohet të riklasifikojë vlerat ndërmjet zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe atyre të të ardhurave gjithpërrfshirëse për aktivet financiare të lejueshme. Shoqëria duhet të paraqesë si zë të veçantë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve vlerën që vjen nga aplikimi i metodës së mbivendosjes, ashtu si dhe një zë të veçantë në pasqyrën e të ardhurave gjithpërrfshirëse për të njëjtin sistemim. Përrjashtimi i përkohshëm aplikohet fillimisht për periudhat raportuese që nisin prej datës 1 janar 2019.

Shoqëria zgjedh të shtyjë afatin e aplikimit të SNRF 9-ës deri më 1 janar 2023, kur hyn në fuqi edhe standardi SNRF 17, dhe gjatë kësaj kohe do vazhdojë të njohë instrumentet e veta financiare duke aplikuar standardin SNK 39.

SNRF 9 Instrumentat Financiarë

Në korrik 2014, BSNK publikoi versionin përrfundimtar të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare-Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9.

SNRF 9 bashkon të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. Përveç kontabilitetit mbrojtës, kërkohet zbatimi retrospektiv, por nuk është i detyrueshëm të jepet informacion krahasues. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkohet në përrgjithësi aplikim në mënyrë prospektive, me disa përrjashtime të kufizuara. Shoqëria plotëson kriteret për përrjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 dhe synon të shtyjë zbatimin e SNRF 9 deri në datën efektive të standardit e ri të kontratave të sigurimit (SNRF 17), që i takon periudhave vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021. Për rrjedhojë, Shoqëria do shtyje aplikimin e ketij standardi deri me 1 janar 2023, kur aplikohet dhe SNRF 17.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

v) Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë aplikuar ende (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)

(i) Klasifikimi dhe Matja

Shoqëria nuk pret ndikim të rëndësishëm nga zbatimi i kërkesave të SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen në pasqyrat e saj financiare. Ajo pret që të vazhdojë të përdorë matjen me kosto të amortizuar për të gjitha aktivet financiare të cilat aktualisht Shoqëria ka në pasqyrat e veta të pozicionit financiar. Të arkëtueshmet mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe pritet të japin rritje të flukseve të mjeteve monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe/apo të interesit. Kështu, Shoqëria pret që këto do të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar në bazë të SNRF 9. Megjithatë, Shoqëria do të analizojë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të vijë në përfundim se të gjitha këto instrumente kanë përmbushur kriteret për matje me kosto të amortizuar sipas SNRF 9, duke marrë parasysh edhe hyrjen në fuqi të standardit të ri të kontratave të sigurimit.

(ii) Zhvlerësimi

SNRF 9 kërkon që Shoqëria të regjistrojë humbjet e pritshme të letrave me vlerë, kredive dhe të arkëtueshmeve të tjera, mbi një bazë 12-mujore ose gjatë tërë ekzistencës së saj. Shoqëria do të duhet të bëjë një analizë më të detajuar e cila merr në konsideratë të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të bazuara, duke përfshirë elementet largpamës për të përcaktuar shkallën e ndikimit, për të vlerësuar ndikimin e plotë të standardit të ri.

(iii) Kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria beson se të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse ekzistuese të cilat janë aktualisht të përcaktuara si marrëdhënie mbrojtëse do të vazhdojnë të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Sikurse SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme se si një njësi ekonomike kontabilizon mbrojtjet efektive, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17-Kontratat e Sigurimeve, një standard i ri kontabël gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe dhënien e shënimeve shpjeguese. Pasi të jetë efektivë, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 -Kontratat e Sigurimeve. Në Shtator 2017, Bordi themeloi Grupin e Burimeve Tranzicionale (TRG) për SNRF 17 për të analizuar pyetjet që lidhen me zbatimin e këtij standardi. TRG është mbledhur katër herë dhe ndërkohe nuk janë planifikuar takime të mëtejshme, procesi i paraqitjes TRG mbetet i hapur për palët e interesuara për të dërguar pyetje që ata besojnë se i plotësojnë kriteret e paraqitjes në TRG.

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jete, jojete, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) dhe llojet e subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë. Do të zbatohen disa përjashtime nga fushëveprimi.

Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model të kontabilitetit për kontratat e sigurimit që është më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguresit.

Në kundërshtim me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, që mbulon të gjitha aspektet relevante të kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar nga:

- Një adaptim specifik për kontratat me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë karakteristikat (qasja e tarifës së ndryshueshme)
- Një qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit të primit) kryesisht për kontrata me kohëzgjatje të shkurtër

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

v) Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë aplikuar ende (vazhdim)

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (vazhdim)

Tiparet kryesore të modelit të ri të kontabilitetit për kontratat e sigurimit janë si më poshtë:

- Matja e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, që përfshijnë një rregullim eksplisit të rrezikut, do të rivlerësohet në çdo periudhë raportimi (flukset monetare të përmbushjes)
- Marzhin e Shërbimit Kontraktual (MSK) që është e barabartë dhe e kundërta me çdo fitim të “ditës së pare” në flukset e pritshme të realizimit të një grupi kontratash. MSK përfaqëson perfitueshmerinë e pafituar të kontratave të sigurimit dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së shërbimit (dmth gjatë periudhës së mbulimit)
- Disa ndryshime në vlerën e aktualizuar të flukseve të pritshme monetare të cilat rregullohen kundrejt MSK dhe në këtë mënyrë njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së mbetur të shërbimit kontraktual
- Efekti i ndryshimeve në normat e skontimit do të raportohet në fitim ose humbje ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, të përcaktuara nga një zgjedhje e politikës kontabël
- Prezantimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të shërbimeve të sigurimit në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse bazuar në konceptin e shërbimeve të ofruara gjatë periudhës
- Shumat që policë-mbajtësi gjithmonë do të marrë, pavarësisht nëse ndodh një ngjarje e siguar (komponentë jo të ndashëm të investimeve) nuk paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes, por njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e pozicionit financiar
- Rezultatet e shërbimeve të sigurimit (të ardhurat e fituara minus demet e ndodhura) paraqiten të ndara ndaj të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimeve
- Shenime shpjeguese me të zgjeruara për të dhëna informacion mbi shumat e njohura nga kontratat e sigurimit si dhe natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve që lindin nga këto kontrata.
- SNRF 17 është efektiv për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me detyrim për paraqitje të shifrave krahasuese. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që Shoqëria të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës së zbatimit të parë të SNRF 17.

Bordi vendosi për një qasje retrospektive për vlerësimin MSK në datën e tranzicionit. Megjithatë Shoqëria mund të zgjedhë midis metodës së paraqitjes së modifikuar retrospektive ose metodës me vlerën e drejtë. Shoqëria planifikon të miratojë standardin e ri në datën e kërkuar në fuqi së bashku me SNRF 9 (shih më lart). Shoqëria nuk ka nisur ende të vlerësojë ndikimin prej implementimit të SNRF 17. Shoqëria pret që standardi i ri do të rezultojë në ndryshime të rëndësishme në politikën kontabël për detyrimet e kontratave të sigurimit dhe ka gjasa të ketë një ndikim të rëndësishëm në rezultatit dhe kapitalin e Shoqërisë së bashku me prezantimin dhe shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare

Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialitetit

Në tetor 2018, IASB publikoi ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet” duke nënvizuar përkufizimin e “materialitetit” përgjatë standardeve dhe duke sqaruar disa aspekte të përkufizimit. Përkufizimi i ri shprehet se ‘Informacioni është material nëse mënjanimi, gabimi apo fshehja në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare marrin mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacionin financiar në lidhje me një njësi të veçantë raportuese. Ndryshimet në përkufizimin e materialitetit nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria do t’i zbatojë standardet më poshtë kur ato të hyjnë në fuqi, por ka pritshmërinë që ato nuk do të kenë impakt në pasqyrat financiare të saj pasi ato nuk janë të aplikueshme për Shoqërisë.

- **Ndryshime në SNRF 3: Përkufizimi i një Biznesi.**
- **Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar**
- **Reforma e Standardit të Normës së Interesit Benchmark - Ndryshime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7**

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

v) Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë aplikuar ende (vazhdim)

Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë të tij apo Sipërmarrjes së Përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28.

- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)

Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

u) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shumën të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

v) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4. VLERËSIME DHE GJYKIME KONTABËL

Këto shënimesh përgjeshëse shtohen shpjegimeve në lidhje me manaxhimin e rrezikut financiar (shënimi 6) dhe manaxhimin të rrezikut të sigurimit (shënimi 5). Shoqëria kryen vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që kryhen në përgjithësi ndryshojnë nga rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe gjykimet të cilat mbartin rrezikun e krijimit të ndonjë sistemi të rëndësishëm në vlerën e mbetur të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar në vijim diskutohen më poshtë.

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkakimin e një sistemi material në shumën e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumën të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

4. VLERËSIME DHE GJYKIME KONTABËL(VAZHDIM)

Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimeve

Provizionet për humbjet e kredisë

Aktivët paraqiten me kosto të amortizuar dhe rishqyrtohen për zhvlerësim bazuar në përkrahjet e politikës kontabël në shënimin 3, mbi zhvlerësimin e aktiveve financiare.

Komponenti individual në totalin e provizioneve aplikohet ndaj dëmeve të vlerësuara individualisht për provigjion dhe bazohet në vlerësimet më të mira të manaxhimit mbi vlerën aktuale të flukseve monetare të pritshme për t'u arkëtuar. Në vlerësimin e këtyre flukseve monetare, manaxhimi kryen vlerësime të situatës financiare të palës përkatëse dhe vlerës së realizueshme neto të kolateralëve mbështetës.

Vlerësimi i pasigurisë në lidhje me provigjionet

Vlerësimet më të rëndësishme në lidhje me pasqyrat individuale financiare të shoqërisë lidhen me provizionet. Shoqëria zbaton parimin e kujdesit të arsyeshëm në lidhje me provizionimin dhe aplikon rregulla dhe rregullore të përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë si edhe ato të përkrahura në shënimin 3. Shoqëria punëson matematicienë në pozicionin e aktuarit.

Politika e Shoqërisë është bërja e provizionit për rrezikun e paskaduar që krijohet nga sigurimet e jo-jetës ku dëmet dhe shpenzimet administrative të cilat mund të lindin pas fundit të vitit financiar në lidhje me kontrata të lidhura para asaj date priten të tejkalojnë primet e pafituar dhe atë të vlefshëm sipas këtyre kontratave. Drejtimi është i besimit se niveli i rezervave teknike është i mjaftueshëm.

Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se nuk ka rreziqe të rëndësishme në lidhje me sa më sipër në datën e raportimit. Përhapja e Coronavirus të ri ka ndikuar në aktivitetet e biznesit dhe ekonomisë në territore të caktuara duke përfshirë territorin e Europës dhe Shqipërisë.

Drejtimi ka marrë në konsideratë ndikimin e pandemisë botërore të Coronavirus në pasqyrat financiare, duke konsideruar nëse ndikimet e shpërthimit të koronavirusit kanë implikime pasuese të kontabilitetit dhe raportimit financiar që mund të përfshijnë jo vetëm matjen e aktiveve dhe detyrimeve, por edhe zbulimin e ngjarjeve pas datës së bilancit dhe shënimeve të tjera shpjeguese, dhe përgatitjen e pasqyrave financiare mbi bazën e vijimesise se aktivitetit.

Për vitin 2021 nuk mendohet që pandemia të ketë impakt sinjifikativ në primet e shkruara të sigurimit, por nga vetë natyra e aktivitetit të shoqërisë ku pjesa më e madhe e primeve arkëtohet nga institucione bankare të cilat kanë likuiditet të lartë, devijancat në primet e shkruara bruto, shoqëruar me një politikë të kujdesshme të shpenzimeve të administrimit nuk do të ketë impakt në fitimin e parashikuar, ashtu sic nuk do të afektojë treguesit financiarë të kompanisë. Drejtimi gjykon se ky event nuk ka asnjë impakt në lidhje me aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të raportuara në pasqyrat financiare më 31.12.2020, dhe se as mund të çënoje vijueshmerinë e aktivitetit të shoqërisë. Megjithatë, niveli i biznesit të shoqërisë është në varësi të volumit të kredive të lëshuara nga Bankat, që mund të pesojnë një rënie në vijim të situatës së pandemisë.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË SIGURIMIT

Objektivi kryesor i strukturës së administrimit të rrezikut dhe financiare të Shoqërisë është për të mbrojtur aksionarët e Shoqërisë nga ngjarjet që pengojnë arritjen e qëndrueshëm të objektivave të performancës financiare, duke përfshirë dështimin për të shfrytëzuar mundësitë. Drejtimi njih rëndësinë kritike për të pasur sisteme efikase dhe efektive të administrimit të rrezikut.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përlogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të politikave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve.

Shoqëria ka krijuar një politike dhe funksion të administrimit të rrezikut me terma të qarta referimi nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë. Objekti i kësaj rregulloreje është percaktimi i parimeve baze mbi të cilat Shoqëria nderton sistemin e administrimit të rrezikut si dhe i procedurave dhe politikave për identifikimin, matjen dhe kontrollin e rreziqeve të Shoqërisë. Kjo rregullore është hartuar në baze dhe për zbatim të Ligjit Nr.52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", neni 27 dhe Rregullores Nr.5 datë 05.11.2019 "Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqëri të sigurimit".

Supozimet kryesore që kanë efektin më të madh në aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e njohura të sigurimit

Provizioni bëhet në datën e raportimit për kostot përfundimtare të pritshme të shlyerjes për të gjitha dëmet e ndodhura në lidhje me ngjarje deri në atë datë, pavarësisht nëse janë të raportuara apo jo, bashkë me shpenzimet e administrimit të dëmeve, minus shumat e paguara.

Detyrimi për dëmet e raportuara por jo të paguara (RBNS) vlerësohet si i ndarë rast pas rasti duke i dhënë rëndësinë e duhur shkaqeve të dëmit, informacionit të marrë nga vlerësuesit e humbjes dhe nga të dhënat historike të përmasave të dëmeve të ngjashme. Rezervat e rasteve rishqyrtohen rregullisht dhe përditësohen kur ka informacion të ri.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por të pa-raportuara (IBNR) është përgjithësisht subjekt i një shkalle më të lartë pasigurie sesa për dëmet të raportuara. Provizionet e IBNR janë kryesisht të vlerësuara nga aktuarët e Shoqërisë duke përdorur teknika statistikore, përmes të cilave të dhënat historike përdoren në mënyrë që të bëhet një vlerësim i kostove përfundimtare të dëmeve.

Për kontratat e sigurimit të jetës, vlerësimet bëhen si për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të raportuara në deklaratën e datës së gjendjes financiare dhe për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të ndodhura por jo të raportuara ende në Deklaratën e datës së pozicionit financiar ("IBNR"). Kostoja përfundimtare e kërkesave të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të kërkesave të teknikave standarde të projektimit.

Supozimi kryesor në themel për këto teknika është se për një kompani pretendimet e kaluara si përvojë zhvillimi mund të përdoren për projektin e zhvillimit të kërkesave të ardhshme dhe kostot përfundimtare. Si të tilla, këto metoda nxjerrin zhvillimin e paguar dhe humbjet e shkaktuara, shpenzimet mesatare për kërkesë dhe numrat e kërkesave të bazuar në zhvillimin e vërejtur vitet e mëparshme dhe raportet për humbje që priten.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË SIGURIMIT (VAZHDIM)

Per llogaritjen e IBNR-se per produktet e sigurimit te Jetes ne kushtet e numrit te ulet te demeve ne cdo portofol, eshte i pamundur perdorimi i metodet se trekendeshave, per kete arsye ne llogaritjen e saj eshte marre ne konsiderate Raporti i Humbjeve per te pakten 3 vitet e fundit te aktivitetit mbi Primin e fituar te periudhave respektive dhe me nje vlere te maksimizuar te raporteve dhe eshte vleresuar raporti i mundshem i humbjeve te periudhes duke percaktuar keshtu Ultimate Reserve per cdo portofol.

Eshte bere analiza e raportit IBNR faktike per cdo nje vit nga periudha ne analize dhe ky eshte optimizuar dhe aplikuar mbi Ultimate rezerve per cdo produkt duke percaktuar keshtu nivelin e IBNR. Nderkohe qe analiza e testeve run-off, ka rezultuar pozitive per te tera produktet.

Nderkohe qe ne portofolin e sigurimit te jetes se Debitorit, ku te dhenat ne vite dhe numri I demeve na e lejojne, eshte aplikuar metoda klasike e IBNR me ane te trekendeshit te zhvillimit te demeve.

Supozimet të cilat kanë efektin më të madh në matjen e detyrimit për sigurimin e jetës janë si më poshtë:

Norma e dëmeve të pritshme

Normat e dëmeve të pritshme është norma e dëmeve të pritshme për të ndodhur ndaj primeve të fituara. Supozimet në lidhje me normat e dëmeve të pritshme për vitet më të fundit të aksidenteve, sipas produktit, kanë ndikimin më të madh në nivelin e provigjioneve.

Distanca kohore

Për produktet me distancë kohore midis ndodhjes së dëmeve, niveli i provigjioneve influencohet shumë nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve nga viti më i fundit i zhvillimit për të cilin të dhënat historike janë të vlefshme deri në shlyerjen më të fundit. Këta faktorë vlerësohen me kujdes bazuar në eksperiencë.

a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe pasiguria për shumën e dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i zakonshëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit ku ajo supozon rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrveshjeve për humbjen.

Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e probabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lind sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperiencia tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

b) Strategjia e marrjes në sigurim

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur lëvizshmërinë e rezultateve të pritshme.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË SIGURIMIT (VAZHDIM)**c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit**

Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshte.

Natyra e rrezikut të mbuluar

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë të tilla si paaftësitë e përkohshme ose të përhershme, mbulimin e shpenzimeve mjekësore, shpenzimet spitalore dhe të riaftësimit. Te tera produktet e kompanise paraqesin karakteristika te produkteve afatshkurter, te rinovueshme cdo vit, duke perfshire opsionin e rregullimit te cmimit dhe asnjera nuk permban element kursimi apo vlere te kthyeshme.

Jeta e debitorit mbulon riskun e vdekjes natyrore apo aksidentale brenda nje afati te percaktuar ne police i cili zakonisht perfshin nje periudhe afatshkurter. Keto polica nuk mbulojne shpenzime te natyrave te tjera pervec ketij risku.

Policat e sigurimit të shëndetit ofrojnë mbulime të humbjes së jetes si dhe paafesite të përhershme apo të përkohshme, duke përfshirë këtu dhe mbulim të shpenzimeve me natyrë spitalore apo jashtë spitalore. Periudha e mbulimit është afatshkurter, zakonisht 1-vjecare, por ofrohet dhe për periudha më të shkurtra nëse personi është në udhëtim.

Policat e tjera të ofruara nga kompania kanë afat 1-vjecar dhe mbulojnë riskun e humbjes natyrore të jetes të shoqëruar me përfitime paafesise ose spitalore gjatë ndodhjes së një aksidenti.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin.

Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin ndaj humbjeve dhe për të minimizuar efektin e humbjeve nga sigurimi i jetës për kreditë nëpërmjet marrëveshjes risiguroese “Marreveshje mbi bazen e rrezikut” (Treaty on Risk Premium Basis) me mbulim deri në shumën 100,000 Euro.

Për produktet e tjera, të cilat kanë shumën të ulët të sigurimit nuk ka marrëveshje në fuqi. Në rastet e risqeve specifike Shoqëria ka kontratë risigurimi të tipit “excess of loss” bazuar në akumulimin e riskut dhe ashpërsinë e ngjarjes.

Tabela e mëposhtme paraqet mbulimin maksimal agregat për kontratat e sigurimit të jetës së kredimarrësve sipas moshës për 31 dhjetorin 2020. Analiza e ekspozimit kontraktual konsiderohet si treguesi më i mirë për përqëndrimin e rrezikut të sigurimit.

Moshë për sigurimin e jetes së kredimarrësve	31 dhjetor 2020	
	Në lekë	Në %
Deri 29	2,459,923,792	9.05%
30 – 39	10,917,945,813	40.17%
40 – 49	8,022,088,332	29.51%
50 – 59	5,104,588,290	18.78%
Mbi 60	675,689,794	2.49%
Totali	27,180,236,021	100%

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË SIGURIMIT (VAZHDIM)

d) Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Shoqëria gjykon se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ka akumuluar ekspozim të rëndësishëm që lidhet me ngjarjen e pandemisë Covid 19. Produkti i jetes së debitorit është produkti i ekspozuar ndaj kësaj ngjarje. Duke marrë në konsideratë që numri i policave tona në fuqi, të cilat e mbulojnë këtë rrisht është 8669 polica në fuqi me datë 31 Dhjetor 2020. Gjatë vitit 2020 janë raportuar 3 deme të humbjes së jetes nga Covid 19 ku totali i raportimeve për këtë produkt ishte 15 në total, ekspozimi ynë për deme të pritshme në këtë portofol (total humbje jete përfshirë edhe Covid 19) është rreth 43 polica, ndërkohe

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

që severitë e rasteve është e paparashikueshme, duke marrë në konsideratë variablat e portofolit në shumat e sigurimit.

Transaksionet me instrumentet financiare rezultojnë për Shoqërinë që të llogarisë rrezikun financiar. Këto përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Shoqëria i menaxhon këto rreziqe.

a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh:

- i. *Rreziku i valutës* – rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të variojë nga ndryshimet në kurset e këmbimit.
- ii. *Rreziku i normës së interesit* – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë nga ndryshimet në treg të normës së interesit.
- iii. *Rreziku i çmimit* – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, qofshin këto ndryshime si rezultat i faktorëve specifik të instrumentit financiar ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentet financiare që janë në treg.

Rreziku i tregut nuk përfshin vetëm mundësinë për të humbur, por edhe mundësinë për të fituar.

Përputhja aktive/detyrim

Shoqëria i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyrë e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksionar.

Shoqëria vendos objektiva për portofol aktivesh për çdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brenda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqëndrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasinë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të arritur objektivat e menaxhimit të aseteve/detyrimeve. Shoqëria ka ndërmarrë disa transaksione në monedhë të huaj. Kështu që, ekspozimi ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit rritet.

Shoqëria gjatë vitit ushtrimor ka marrë masa për të ulur ekspozimin e rrezikut valutës duke u përparësuar që të përputhe sa më përafërsisht aktivet financiare të Shoqërisë me detyrimet e sigurimit dhe kontratat e investimeve sipas monedhave.

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****a) Rreziku i tregut (vazhdim)***i) Rreziku valutor*

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2020 janë si mëposhtë:

31 dhjetor 2020	në Lekë	në EUR	në USD	Totali
Aktive				
Mjete monetare në arke dhe në bankë	2,645,582	3,949,261	377,178	6,972,021
Depozitat me afat dhe të ardhurat nga interesi	488,196,540	55,293,901	1,008,397	544,498,838
Te arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	8,136,389	16,521,976	-	24,658,365
Aktivet e risigurimit	-	13,120,615	-	13,120,615
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura	1,730,252	-	-	1,730,252
Totali i Aktiveve	500,708,763	88,885,753	1,385,575	590,980,091
Detyrimet				
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	53,348,068	16,901,378	1,569,272	71,818,718
Rezerva për primin e pafituar	56,994,520	58,961,776	102,483	116,058,779
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	-	7,958,759	-	7,958,759
Detyrime për tatim fitimin	120,279	-	-	120,279
Detyrimi ndaj qiramarrësve IFRS 16	-	6,739,026	-	6,739,026
Detyrime ndaj institucioneve financiare	-	182,662,754	-	182,662,754
Detyrime të tjera	8,338,463	4,124,562	1,466,327	13,929,352
Totali i detyrimeve	118,801,330	277,348,255	3,138,082	399,287,667
Pozicioni Neto	381,907,433	(188,462,502)	(1,175,507)	191,692,424

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**a) Rreziku i tregut (vazhdim)***i) Rreziku valutor*

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2019 janë si mëposhtë:

31 dhjetor 2019	ne Lekë	në EUR	në USD	Totali
Aktivet				
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	2,229,293	4,344,007	463,396	7,036,696
Depozitat me afat dhe te ardhurat nga interesi	295,158,680	43,949,025	1,088,611	340,196,316
Letra me vlere te qeverise	187,680,006	-	-	187,680,006
Aktivet e risigurimit	-	8,641,241	-	8,641,241
Te arketueshme nga sigurimi dhe risigurimi	5,872,773	11,241,721	1,195	17,115,689
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	16,858,906	-	-	16,858,906
Tatime te parapaguara	4,964,083	-	-	4,964,083
Aktive te shtyra tatimore	42,279	-	-	42,279
Aktive te tjera	41,800	-	-	41,800
Totali i Aktiveve	512,847,820	68,175,994	1,553,202	582,577,016
Detyrimet				
Detyrimet per humbjet dhe rregullimet per humbjet	51,296,066	11,550,493	1,908,370	64,754,929
Rezerva për primin e pafituar	59,518,250	56,504,331	110,303	116,132,884
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	-	2,638,415	-	2,638,415
Detyrime per qirane financiare	-	491,582	-	491,582
Detyrimi ndaj qiradhenesi IFRS 16	390,106	11,321,416	-	11,711,522
Detyrime te tjera	6,126,625	4,048,214	8,657	10,183,496
Totali i detyrimeve	117,331,047	86,554,451	2,027,330	205,912,828
Pozicioni neto	395,516,773	(18,378,457)	(474,128)	376,664,188

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****a) Rreziku i tregut (vazhdim)***ii) Rreziku i normës së interesit*

Tabelat e mëposhtme paraqesin aktivet dhe detyrimet financiare që mbartin interes të Shoqërisë të analizuar në bazë të periudhave të riçimitit e përcaktuar si periudha më e hershme midis periudhës së mbetur deri në maturim sipas kontratës dhe periudhës së riçimitit sipas kontratës. Tabelat janë një llogaritje e rrezikut të normës së interesit për grupin më 31 dhjetor 2020 dhe nuk janë tregues për periudha të tjera gjatë vitit, por japin një të dhënë për ndjeshmërinë e të ardhurave të Shoqërisë ndaj lëvizjeve në normat e interesit. Të ardhurat ndikohen gjithashtu dhe nga monedha e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit. Shoqëria ka një pjesë të rëndësishme të aktiveve që mbartin interes të shprehura në monedhë të huaj.

	Norma efektive e interesit	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	Më teper se 1 vit	Totali
31 dhjetor 2020					
Aktive financiare					
Depozita me afat	1.47%	28,308,558	149,792,000	366,398,280	544,498,838
Totali i aktiveve financiare		28,308,558	149,792,000	366,398,280	544,498,838
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj institucioneve financiare	3.50%	5,181,207	4,635,067	172,846,480	182,662,754
Detyrimi I qirase sipas IFRS 16	5.11%	2,473,551	2,537,426	1,728,049	6,739,026
Total i detyrimeve financiare		7,654,758	7,172,493	174,574,529	189,401,780

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**a) Rreziku i tregut (vazhdim)***iii) Rreziku i kredisë*

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale duke sjellë humbje financiare për Shoqërinë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në depozitat me afat dhe të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi i palës tjetër. Drejtimi beson se rreziku i kredisë i lidhur me depozitat me afat nuk është i rëndësishëm.

Shoqëria e menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në baza të vazhdueshme duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi.

Të arkëtueshmet neto nga sigurimi dhe risigurimi më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 sipas vjetërsisë së tyre janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	në Lekë	në %	në Lekë	në %
1 - 90 ditë	15,035,106	77.65%	9,094,505	46.97%
91 - 365 ditë	8,437,930	43.58%	2,952,679	15.25%
> 365 ditë	27,571	0.14%	5,068,505	26.18%
Totali	23,500,607	100.00%	17,115,689	100.00%

b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të mund të përballojë detyrimet që lidhen me pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare.

Shoqëria ka adoptuar një strukturë të përshtatshme në administrimin e likuiditetit për të siguruar vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikoje të demtoje emrin e saj.

Shoqëria e menaxhon rrezikun e likuiditetit duke mbajtur mjete monetare bankare dhe depozita me maturim afatshkurt duke monitoruar vazhdimisht flukset monetare të parashikuara dhe aktuale dhe duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit që lind nga klientët si pasojë e kontratave të sigurimit.

Menyrat kryesore të përdorura nga Shoqëria për administrimin e rrezikut të likuiditetit janë raportet e likuiditetit dhe vlerësimi i hendekut për periudha specifike.

Menaxhimi i likuiditetit siguron që Shoqëria ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar dëmet nga sigurimi dhe detyrimet e maturuara.

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit sipas maturitetit kontratual më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

31 dhjetor 2020	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali
Aktive						
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	6,972,021	-	-	-	-	6,972,021
Depozitat me afat	265,753	9,490,405	168,344,400	366,398,280	-	544,498,838
Aktivitet e risigurimit	604,310	19,478,261	4,575,794	-	-	24,658,365
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	5,629,742	1,706,330	5,784,543	-	-	13,120,615
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	1,730,252	-	-	-	-	1,730,252
Totali i Aktiveve	15,202,078	30,674,996	178,704,737	366,398,280	-	590,980,091
Detyrimet dhe kapitali aksioner						
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	534,591	11,399,613	17,928,414	22,547,341	19,408,759	71,818,718
Rezerva për primin e pafitur dhe rezerva të tjera	1,566,310	36,973,296	69,582,605	6,980,323	956,245	116,058,779
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	-	7,958,759	-	-	-	7,958,759
Detyrime ndaj institucioneve financiare	1,268,130	2,322,817	6,220,269	51,860,003	120,991,535	182,662,754
Detyrime të tjera	1,319,681	12,729,950	-	-	-	14,049,631
Detyrime per qirane_IFRS 16	407,891	821,002	3,782,083	1,728,050	-	6,739,026
Totali i detyrimeve	5,096,603	72,205,437	97,513,371	83,115,717	141,356,539	399,287,667
Hendeku i maturitetit	10,105,475	(41,530,441)	81,191,366	283,282,563	(141,356,539)	191,692,424
Efekti i akumuluar	10,105,475	(31,424,966)	49,766,400	333,048,963	191,692,424	-

*(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)***6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit sipas maturitetit kontratual më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

31 dhjetor 2019	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali
Aktive						
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	7,036,696	-	-	-	-	7,036,696
Depozitat me afat	-	8,542,214	210,704,927	120,949,175	-	340,196,316
Investime në letra me vlerë	-	-	187,680,006	-	-	187,680,006
Aktivitet e risigurimit	960,510	1,009,173	6,671,558	-	-	8,641,241
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	9,094,505	2,952,679	5,068,505	-	-	17,115,689
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	16,858,906	-	-	-	-	16,858,906
Aktive të tjera	41,800	-	-	-	-	41,800
Totali i Aktiveve	33,992,417	12,504,066	410,124,996	120,949,175	-	577,570,654
Detyrimet dhe kapitali aksioner						
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	304,425	12,481,768	18,844,155	20,240,278	12,884,303	64,754,929
Rezerva për primin e pafitur dhe rezerva të tjera	1,189,621	32,416,295	49,478,815	32,294,390	753,764	116,132,884
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	-	2,638,415	-	-	-	2,638,415
Detyrime për qiranë financiare	49,000	98,000	344,581	-	-	491,582
Detyrime për tatim fitimin	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	2,036,699	7,128,447	1,018,350	-	-	10,183,496
Detyrime për qirane IFRS 16	-	1,294,638	3,783,132	6,633,752	-	11,711,522
Totali i detyrimeve	3,579,745	56,057,564	73,469,032	59,168,420	13,638,067	205,912,829
Hendeku i maturitetit	30,412,672	(43,553,498)	336,655,964	61,780,755	(13,638,067)	371,657,826
Efekti i akumuluar	30,412,672	(13,140,826)	323,515,138	385,295,893	371,657,826	-

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**c) Interesi teknik**

Normat e interesit teknik këtë vit janë llogaritur më vete për çdo monedhë përkatësisht ALL (3.6%-0.1%), EUR (0.001%-1.4%), dhe USD 0.4%) në varësi të normave mesatare të depozitave bankare.

Norma e interesit teknik është minimumi i kthimit të garantuar për cdo kontratë sigurimi për jetën.

Ka një rrezik që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë minimumin e kthimeve të garantuara.

d) Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimit me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i limituar në analizën e parametrave kryesorë të cilat kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës.

Analizat e parametrave aktuarialë të përdorura në llogaritjen e tarifave dhe rezervave për sigurimin e jetës tregojnë që supozimet e bëra janë të besueshme dhe të sakta. Zhvillimi i favorshëm i rrezikut krahasuar me vlerat e pritshme garanton që rezervat janë matur në mënyrë të saktë.

Rreziku i risigurimit

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, subjekt i disa rrethanave për limitet maksimale të bazuara në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakord që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij. Kur zgjedh risiguruesin Shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tij. Siguria e risiguruesit vlerësohet nga informacionet publike të kategorizimeve dhe nga investigime të brëndshme. Risiguruesi aktual ka një vlerësim AA Të qëndrueshme nga "Standard and Poor's".

e) Analiza e sensitivitetit

Faktorët kryesorë të cilët ndikojnë fitimin e Shoqërisë janë niveli i dëmeve dhe shpenzimet.

31 dhjetor 2020	Fitimi	Kapitali neto	Fondi i garancisë i kërkuar (Shënimi 9)
Aktual	83,755,184	590,000,000	370,000,000
Rritje në dëmet e ndodhura	-10,732,831	579,267,170	370,000,000
Rritje në shpenzime (+10%)	-2,154,210	577,112,959	370,000,000

31 dhjetor 2019	Fitimi	Kapitali neto	Fondi i garancisë i kërkuar (Shënimi 9)
Aktual	59,387,954	429,387,954	370,000,000
Rritje në dëmet e ndodhura	-10,565,374	418,822,580	370,000,000
Rritje në shpenzime (+10%)	-1,418,387	417,404,193	370,000,000

Tabela më sipër paraqet një simulim, duke marrë në konsideratë ndryshime për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime me 10% secila dhe efekti i saj në kapitalin neto të Shoqërisë dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhur gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

f) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat kryesorë të Shoqërisë kur menaxhojnë kapitalin janë në përputhje me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit, duke garantuar mundësinë e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë, në mënyrë që ajo mund të vazhdojë të gjenerojë fitime për aksionerët dhe përfitime për përfituesit e tjerë. Enti rregullator i Shoqërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare Shqiptare, vendos dhe monitoron kërkesat për kapitalin në mënyrë që të mbajë në çdo kohë kapitalin e sigurimit për sigurimin e jetës i cili të paktën të jete i barabartë me nivelin e detyrueshëm të aftësisë paguese për sipërmarrjen siguroese. Në përputhje me ligjin shqiptar për sigurimin kapitali rregullator përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. Kapitali bazë përfshin:

- kapitalin e paguar;
- fitimin e vitit aktual dhe të akumuluar;
- rezerva të rivleresimit

Kapitali bazë nuk përfshin:

- kapitalin e papaguar;
- aktivet e patrupëzuara;
- humbjet e vitit aktual dhe të akumuluar

Kapitali bazë nuk përfshin kontributin në natyrë dhe nuk duhet të jetë më i vogël se fondi i garancisë së përcaktuar. Fondi i garancisë është 370 milion lekë.

Shoqëria administrohet kapitalin e saj në mënyrë që të jete i mjaftueshëm, minimalisht sa fondi i garancisë, i cili për veprimtarinë e shoqërisë në RSH.

Investimet e shoqërisë, duhet të respektojnë kufijtë maksimale të raportit me kapitalin rregullator të Shoqërisë. Ekspozimi ndaj një banke të vetme nuk duhet të jetë më shumë se 25% e kapitalit rregullator.

Rreziku i kapitalit (aftësisë paguese) administrohet nepermjet matjeve të vazhdueshme. Llogaritja e nivelit të kerkuar të aftësisë paguese të shoqërisë kryhet periodikisht, si dhe raportohet në strukturat perkatëse.

Në rastet kur rrezikohen interesat e të siguruarve dhe/ose niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, shoqëria mund të detyrohet të depozitojë një plan rimëkëmbjeje financiare, të shoqëruar me masat riorganizative të propozuara për të paktën tre vitet e ardhshme financiare. Keto masa nënkuptojnë masat që kanë qëllim mbajtjen apo rivendosjen e gjendjes së shëndoshë financiare të Shoqërisë.

7. PËRDORIMI I LLOGARITJEVE DHE GJYKIMIT

a) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve.

Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe për periudhat e ardhshme të cilat ndikohen. Në veçanti, informacion rreth fushave më kryesore për llogaritjen e pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 7, dhe 34.

Shoqëria bën llogaritje dhe supozime që influencojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve gjatë një viti fiskal. Llogaritjet dhe gjykimet janë vlerësuar rregullisht dhe janë bazuar në informacionet e tregut dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethana të caktuara.

7. PËRDORIMI I LLOGARITJEVE DHE GJYKIMIT (VAZHDIM)

a) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit (vazhdim)

(i) Llogaritja e detyrimit nga sigurimi

Shiko shënimin 3.d).

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Politika kontabël e Shoqërisë për matjen e vlerës së drejtë është diskutuar në politikën kontabël 3 d)(vi). Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e inputeve në bërjen e matjeve:

-Niveli 1: Çmimet e tregut të kuotuar (të pakorrigjuara) në një treg aktiv për instrumenta identik.

-Niveli 2: Metoda vlerësimi të bazuara në të dhënat të vëzhgueshme, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (për shembull çmimi) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (për shembull si rezultat i çmimit). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregje aktive për instrumente të njëjtë; çmimet e kuotuar për instrumente identikë ose të njëjtë në treg që konsiderohen më pak aktive; ose metoda vlerësimi ku të gjithë të dhënat hyrëse janë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

-Niveli 3: Metoda vlerësimi duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet ku metoda e vlerësimit merr parasysh faktorë bazuar në të dhëna jo të vëzhgueshme të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të njëjta ku korrigjime të pavëzhgueshme të konsiderueshme ose supozime janë të detyruara që të reflektojnë diferencat midis instrumenteve.

Metodat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve të parasë, krahasime me instrumente të njëjta për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuara në ecurinë aktuale të "yield"-it të përshtatshme për pjesën e mbetur të maturitetit. Supozimet dhe faktorët e përdorur në metodat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa rrezik dhe të tregut, normat e kredihënies dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, obligacionet dhe çmimi i kapitalit, kurset e këmbimit, çmimi i kapitalit dhe çmimi i indeksuar i kapitalit dhe luhatjet e pritshme dhe të lidhura me njëra-tjetrën. Objektivi i metodave të vlerësimit është që të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë e cila reflekton çmimet e instrumentave financiarë në datën e raportimit, që do të ishin përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg duke vepruar në kushte normale tregu.

8. PARAQITJA E VLERËS SË DREJTË

Llogaritjet e vlerës së drejtë janë bazuar në instrumentet financiare ekzistuese në pasqyrën e pozicionit financiar pa u përpjekur që të llogaritet vlera e ardhshme e biznesit dhe vlera e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk konsiderohen instrumente financiare.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to dhe Depozita me afat me bankat - të cilat përfshijnë paranë në banka dhe depozitat me afat, përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe zëra në proces mbledhjeje. Duke qënë se depozitat janë afatshkurtra dhe me norma të luhatshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e afërt me vlerën e tyre kontabël

Bono Thesari – Bonot e Thesarit janë aktive që mbahen deri në maturim dhe mbartin interes. Aktualisht nuk ekziston një treg aktiv për tregtimin e tyre dhe vlera e drejtë është llogaritur duke përdorur modelin e zbritshëm të fluksit të parasë duke u bazuar në interesin përkatës për periudhën e mbetur deri në maturim. Vlera e drejtë është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre.

Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme - Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme, është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre.

8. PARAQITJA E VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)

Llogari te arketueshme nga palet e lidhura - Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve nga palet e lidhura është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre. Shoqëria pret që ti rikuperoj brenda vitit.

Aktive të tjera – Vlera e drejtë e aktiveve të tjera, është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Qira financiare – Vlera e drejtë e detyrimit për qirane financiare është e përafert me vlerën e mbartur për shkak të aktualizimit të ketij detyrimi në datën e raportimit të pasqyrave financiare.

Llogari te pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe risigurimit - Vlera e drejtë e të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe risigurimit, është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre. *Detyrimet e tjera* - Vlera e drejtë e detyrimeve të tjera, është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër.

	Të mbajtura deri në maturim	Kosto amortizimi	Totali i vlerës së mbartur	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2020				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	6,972,021	6,972,021	6,972,021
		544,498,83	544,498,83	544,498,83
Depozita me afat	-	8	8	8
Aktive të tjera	-	493,620	493,620	493,620
Llogari te arketueshme	-	23,500,607	23,500,607	23,500,607
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	-	1,730,252	1,730,252	1,730,252
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	-	15,697,603	15,697,603	15,697,603
Detyrime ndaj institucioneve financiare		182,662,754	182,662,754	182,662,754
	-	775,555,695	775,555,695	775,555,695
31 dhjetor 2019				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	7,036,696	7,036,696	7,036,696
Depozita me afat	-	340,196,316	340,196,316	340,196,316
Letra me vlerë	187,680,006	-	187,680,006	188,151,726
Aktive të tjera	-	48,000	48,000	48,000
Llogari te arketueshme	-	17,115,689	17,115,689	17,115,689
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	-	16,858,906	16,858,906	16,858,906
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	-	2,638,415	2,638,415	2,638,415
Qira financiare	-	491,582	491,582	491,582
	187,680,006	384,385,604	572,065,610	572,537,330

9. MJETE MONETARE NË ARKË DHE EKUIVALENTË ME TO

Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në arkë		-
Nëntotali i mjeteve monetare në bankë		
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	2,645,582	2,229,293
Mjete monetare në bankë në monedhë vendase	4,326,439	4,807,404
Mjete monetare në arkë dhe bankë	<u>6,972,021</u>	<u>7,036,697</u>
Totali	<u>6,972,021</u>	<u>7,036,697</u>

Depozita me afat me maturim më pak se tre muaj, janë klasifikuar si mjete monetare në bankë. Të gjitha mjetet monetare në arkë dhe në bankë, plotësojnë përkufizimin e mjeteve monetare dhe të tjera ekuivalente.

Mjetet monetare në bankë në monedhë të huaj janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
EURO	3,949,261	4,344,007
Dollarë Amerikanë (USD)	377,178	463,396
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	<u>4,326,439</u>	<u>4,807,403</u>

10. DEPOZITAT ME AFAT DHE LETRAT ME VLERE**10.1 Depozita me afat me bankat**

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Depozitat me afat	169,002,300	91,923,600
Depozita Garancie AMF	370,000,000	243,700,000
Interesi i përllogaritur	2,653,258	1,729,436
Balancat e kushtëzuara	<u>2,843,280</u>	<u>2,843,280</u>
Totali	<u>544,498,838</u>	<u>340,196,316</u>

Depozitat per efekt te ngurtesimit te fondit te garancisë paraqesin depozita me afat me maturitet 1 dhe 5 vjeçar në Lekë të vendosura në bankat lokale të cilat janë të kushtëzuara dhe mbahen si garanci në përputhje me nenin 81 të Ligjit Nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit" të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Fondi i garancisë nuk duhet të jetë më pak se 1/3 e kufirit minimal të aftësisë paguese ose jo më pak se 370 milion Lek. Fondi i garancisë së Shoqërisë i cili përbëhet nga depozita me afat me maturitet jo më të vogël se 1 vit ne bankat e nivelit të dytë si dhe investime në letra me vlerë (bono thesari) është mbi nivelin minimal të kërkuar sipas rregullatorit.

Balancat e kushtëzuara i referohet depozites te mbyllur si garanci bankare me qellim garantimin e ecurise se kontrates 3 vjecare mes Insig Jete dhe Bankes se Shqiperise.

Më 31 dhjetor 2020, vlera totale e depozitave per fondin e garancise është Lek 370,000 mijë (2019: Lek 243,700 mijë). Tabela më poshtë paraqet minimimin dhe maksimumin e normave të interesit që janë aplikuar për depozitat deri në maturim gjatë vitit 2019, sipas maturitetit.

	<u>Max</u>	<u>Min</u>
6-Mujore	0.65%	0.01%
1 Vjecare	2%	0.40%
>1 Vjecare	3.60%	1.40%

10. DEPOZITAT ME AFAT DHE LETRAT ME VLERE (VAZHDIM)**10.2 Investime ne letra me vlerë**

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Bono Thesari (Fond Garancie)	-	126,300,000
Bono Thesari	-	63,700,000
Skonto për tu amortizuar	-	(2,319,994)
Bono thesari (neto)	-	187,680,006

Gjatë vitit 2020, Shoqëria duke vlerësuar tendencën në rënie të normës së interesit të letrave me vlerë, investoi në depozita me afat, ndërkohë duke marre në konsiderate menaxhimin e kontrollit te riskut beri edhe diversifikimin e portofolit duke kaluar nje pjesë të investimit të maturuar gjatë vitit 2020 në depozita 5 vjecare. Në shpërndarjen e depozitave u morr parasysh dhe risku i kursit të kembimit si dhe mbulimi i provigjoneve sipas monedhave, duke bërë diversifikimin në monedhë, LEKE, EURO, USD.

11. TË ARKËTUESHMET NGA SIGURIMI, NETO

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Jete ne grup me aksidente personale	7,086,300	5,159,194
Jete dhe shendetit - Flexi Plan	11,140,553	3,193,747
Jetë debitorit	4,404,528	7,121,625
Te arketueshme nga risigurimi	-	510,890
Te tjere	2,026,984	2,285,405
Të arketueshme nga sigurimi	24,658,365	18,270,861
Provigjone për klientë të paarkëtuar	-1,157,758	-1,155,172
Të arketueshme nga sigurimi, neto	23,500,607	17,115,689

11.1 Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura:		
Insig sha	1,730,252	2,763,327
Eurosig sha	-	14,095,579
	1,730,252	16,858,906

12. SHPENZIMET E SHTYRA TË MARRJES NË SIGURIM

Per efekt te llogaritjes se kostove te shtyra te marrjes ne sigurim jane perfshire kostot direkte te marrjes ne sigurim te cilat jane te detajuara sipas produkteve per efekt te komisionit, kostos se policave te shitura dhe shpenzimet e ekzaminimeve. Nderkohe, shpenzimet per reklame dhe marketing te njohura gjithashtu per efekt te shpenzimeve te shtyra jane llogaritur duke marre per baze shpenzimeve faktike te kryera per cdo product gjate 2020.

	31 dhjetor 2020	Ndryshimi për periudhën	31 dhjetor 2019	Ndryshimi për periudhën
Sigurimi i jetes:				
- Jeta e debitorit	21,491,028	5,394,870	16,096,158	2,763,734
- Jeta dhe shendetit te studentit	64,646	-32,796	97,442	-62,883
- Jeta dhe shendetit ne udhetim	140,629	-602,170	742,799	211,438
- Jeta dhe shendetit - Flexi Plan	5,145,427	933,577	4,211,850	1,755,889
- Jeta ne grup me aksidente personale	3,518,644	-62,787	3,581,431	-2,678,007
- Jeta per nxenes dhe student	19,703	-143,762	163,465	-449,260
Totali	30,380,077	5,486,932	24,893,144	1,540,912

13. AKTIVET TË RISIGURIMIT

Gjate vitit 2020 Shoqeria eshte e mbuluar me risigurim ne portofolet e sigurimit Jete Debitori me marrveshje risigurimi, nderkohe qe ka patur dhe nje numer te kufizuar kontratash per te cilat eshte kerkuar risigurim fakultativ. Pervец risigurimit te portofolit te jetes se debitorit, kompania ka marre risgurimi fakultativ te tipit "Excess of Loss" te dedikuar per nje kontrate te sigurimit te jetes ne grup. Provigjoni matematik i risiguresit eshte perlllogaritur ne perputhje te plote me rregulloren per llogaritjen e rezerves matematike.

Nga llogaritjet e Provigjonit te primit te pafiturar pjesa e risiguresit rezulton qe te jete ne vleren bruto 13,120,615 Leke (2019: 8,641,241 Leke. Lëvizjet e aktiveve të risigurimit për 31 dhjetorin 2020 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Në fillim të vitit	8,641,241	9,615,701
Ndryshimi për vitin	4,479,374	(974,460)
Totali	13,120,615	8,641,241

14. AKTIVET TË TJERA

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Inventari i policave	493,620	427,037
Të drejta për tu arkëtuar nga rimbursime	-	41,800
Totali	493,620	468,837

15. TATIME TË PARAPAGUARA

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Tatim në burim	-	2,539,577
Parapagime te tatimfitimit	1,246,775	2,424,506
Fitimi i taksueshëm për vitin	1,246,775	4,964,083

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

16. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVEVE TË SË DREJTËS SË PËRDORIMIT

	Ndërtesa	Makineri e paisje	Mjete Transporti	Paisje zyre e informatike	Permirosim i ambjenteve me qera	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 1 janar 2019	5,173,247	2,509,307	2,862,144	917,205	807,781	12,269,684
Shtesa	-	260,101	-	153,308	-	413,409
Pakesim	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	5,173,247	2,769,408	2,862,144	1,070,513	807,781	12,683,093
Rivleresime	2,156,753	-	-	-	-	2,156,753
Shtesa	-	57,797	-	167,770	-	225,567
Pakesim	(2,630,000)	(74,260)	-	(88,084)	-	(2,792,344)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,700,000	2,752,945	2,862,144	1,150,199	807,781	12,273,069
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 1 janar 2019	504,391	635,668	1,030,372	308,161	323,112	2,801,704
Amortizimi i vitit	233,443	399,483	366,354	169,437	161,556	1,330,273
Gjendja më 31 dhjetor 2019	737,834	1,035,151	1,396,726	477,598	484,668	4,131,977
Rivleresime	(737,834)	-	-	-	-	(737,834)
Pakesime ne amortizim	(120,542)	(41,308)	-	(50,215)	-	(212,065)
Shtesa ne amortizim	355,542	346,851	293,084	169,560	161,556	1,326,593
Gjendja më 31 dhjetor 2020	235,000	1,340,694	1,689,810	596,943	646,224	4,508,671
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	4,435,413	1,734,257	1,465,418	592,915	323,113	8,551,116
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,465,000	1,412,251	1,172,334	553,256	161,557	7,764,398

Shqeria ka bere rivleresimin e ndertesave prane nje vleresuesi te licencuar. Nga rivleresimi i tyre rezultoi nje rritje ne vlere 5,613 mije leke. Gjithashtu ,bazuar ne Vendimin e asamblese se pergjithshme te aksionereve, dt 7/12/2020 ,u cregjistruan nga librat kontabel ndertesa e Gjirokastrës dhe e Kucoves , ku certifikata e pronesisë rezultojn te jete ne emer te Insig sha. Ndertesa e Bulqizes u shit duke e cuar vleren neto te ndertesave 4,465 mije leke me 31.12.2020

16. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVEVE TË SË DREJTËS SË PËRDORIMIT DHE DETYRIMI I QIRASE (VAZHDIM)

Më poshtë janë paraqitur vlerat kontabël të aktiveve të drejtës së qirase dhe detyrimeve të qirasë (përfshirë në Shënimin 19) së bashku me lëvizjet gjatë periudhës:

	E drejta e përdorimit të qirase		Detyrimi i qirase	
	Ndertesa	Totali	Ndertesa	Totali
Gjendja në 01.01.2019	15,989,678	15,989,678	15,989,678	15,989,678
Shtesa	578,719	578,719	390,106	390,106
Shpenzime amortizimi Selia	(4,780,953)	(4,780,953)	-	-
Shpenzime amortizimi Shkodra	(192,906)	(192,906)	-	-
Shpenzime interesi	-	-	721,363	721,363
Pagesa	-	-	(5,413,363)	(5,413,363)
Rivleresimi nga kursi i kembimit	-	-	23,739	23,739
Gjendja më 31.12.2019	11,594,537	11,594,537	11,711,522	11,711,522
Gjendja 01.01.2020 Selia	11,208,725	11,208,725	11,321,416	11,321,416
Gjendja 01.01.2020 Shkodra	385,813	385,813	390,106	390,106
Shtesa	-	-	-	-
Shpenzime amortizimi selia	(4,803,739)	(4,803,739)	-	-
Shpenzime amortizimi Shkodra	(385,813)	(385,813)	-	-
Shpenzime interesi	-	-	486,744	-
Pagesa	-	-	(5,634,832)	4,757,982
Rivleresimi nga kursi i kembimit	-	-	175,592	-
Gjendja më 31.12.2020	6,404,986	6,404,986	6,739,026	-

Analiza e maturimit të detyrimeve të qirasë shpallet në shënimin 19.1. Shoqëria ka pagesa totale për qirane 5,634,532 Lekë. Zbatimi fillestar i SNRF 16 rezultoi në shtesa jo monetare në asetet e përdorimit të së drejtës dhe detyrimet e qirasë prej 15,989,678 lekë në 1 janar 2019.

17. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE

Kosto	License
Gjendja më 1 janar 2019	3,365,770
Shtesa	132,000
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,497,770
Shtesa	489,925
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,987,695
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 01.01.2019	(420,493)
Amortizimi i vitit	(521,365)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(941,858)
Amortizimi i vitit	(530,790)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(1,472,648)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,555,912
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,515,047

18. AKTIV AFATGJATE I INVESTUAR

Me 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka aktiv afatgjate të investimit prej 437,969,486.00 Leke, që perbehet nga toka në Sarandë në vlerë 4,702,020 Leke, toka në Tiranë në vlerë 220,000,000 dhe Vilen në Palas në vlerë 213,267,466 Leke. Vila në Palas është e financuar 70% me kredi të marre pranë Bankes së Tiranës dhe është lënë si kolateral kundërsht kredise. Aktivet e investimit më 31.12.2020 paraqiten si mëposhte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Truall në Sarandë	4,702,020	4,702,020
Truall në Tiranë	220,000,000	-
Parapagim për aktive të mbajtur për investime	212,764,000	-
Kapitalizim i interesave dhe dhe kosto të tjera	503,466	-
Total aktive të mbajtura për investim	<u>437,969,486</u>	<u>4,702,020</u>

19. DETYRIME TË TJERA

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë	11,322,932	6,635,601
Personeli, Kontributi i Sig.shoqërore, Tatimi mbi të ardhurat	931,039	1,176,275
Taksa dhe tatime të tjera të ndryshme nga tatimi fitimi	-	97,696
Detyrime të perlllogaritura	1,522,017	1,301,558
Kreditorë të tjerë	153,364	972,366
	<u>13,929,352</u>	<u>10,183,496</u>

19.1 Detyrimi ndaj qiradhenesit SNRF 16

Analiza e maturimit të detyrimeve të qirasë paraqitet si mëposhte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrimet e qirasë afatshkurtra	5,010,977	5,077,736
Detyrimet e qirasë afatgjata	1,728,049	6,633,786
Detyrimet totale të qirasë	<u>6,739,026</u>	<u>11,711,522</u>

20. LLOGARI TË PAGUESHME SIGURIMIT DHE RISIGURIMI

Llogari të pagueshme për risigurimin lindin nga kontratat e risigurimit me SCOR Global Life, për mbulimin e rrezikut nga sigurimi i Jetë Debitore dhe kontrat e sigurimit nga aksidentet personale dhe sigurimin e jetes me shendet. Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2020 janë 7,958,759 Lekë (2019: 2,638,415 Lekë). Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe risigurimit paraqiten si mëposhte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime nga veprimtaria risigurimit	7,958,759	2,638,415
	<u>7,958,759</u>	<u>2,638,415</u>

21. QIRA FINANCIARE

Shoqëria ka shlyer te gjithë detyrimin per qirane financiare ka trashëguar një marrëveshje qiraje financiare të lidhur mes Insig sh.a dhe Landeslease sh.a më 2016 për blerjen automjetit. Ne 01.09.2020 perfundoi dhe afati i qirase financiare ku shoqëria i kaluan te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne lidhje me automjetin.

21.1 HUATE

Shoqëria marre nje kredi bankare prane Tirana Bank,me afat maturimi 15 vjecar, norme 3.5% ne vlere 1.48 mln Euro, per te cilen ka lene si kolateral objektin e blere ne Palas, sipas kontrates se siper marrjes date 17.07.2020,Rep 8811,Kol 1452 lidhur me Green Cost.

	Monedha	Norma e Interesit	Principali i Huase	Shuma ekujvalente ne leke	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit
Kredi ne Tirana Bank	Euro	3.50%	1,480,000	183,076,000	9,378,662	173,697,338
Shpenzime te parapagara disbursim kredie	Euro	-	(7,359)	(911,633)	(60,776)	(850,857)
Shpenzime te perlllogaritura_Linja e kredise	Euro	-	4,029	498,387	498,387	-
		-	1,476,670	182,662,754	9,816,273	172,846,481

22. DETYRIMET PËR HUMBJEN DHE SHPENZIMET PËR RREGULLIMIN E HUMBJES

Lëvizja e detyrimeve për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	7,198,595	54,368,336
Risigurimi i rikuperueshëm	-	-
Detyrimet neto me 1 janar	7,198,595	54,368,336
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të ndodhura	9,151,434	(107,309,829)
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të paguara	55,603,496	61,296,085
Detyrimet neto më 31 dhjetor	71,953,525	8,354,592
Risigurimi i rikuperueshëm	-	(1,155,997)
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	71,953,525	7,198,595

Vonesa ndodhin në njoftimin e dëmeve dhe një masë e konsiderueshme e përvojës dhe gjykimit përfshihet në vlerësimin e detyrimeve të papaguara të sigurimit, kostot përfundimtare të të cilave nuk mund të vlerësohen me siguri në datën e raportimit. Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet për rregullimet nga humbjet përcaktohen mbi bazën e informacionit në dispozicion; gjithsesi, është e natyrshme në natyrën e biznesit që detyrimet përfundimtare mund të variojnë si rezultat i zhvillimeve të mëvonshme.

22. DETYRIMET PËR HUMBJEN DHE SHPENZIMET PËR RREGULLIMIN E HUMBJES(VAZHDIM)**22.1 Demet e paguara**

Demet e paguara sipas llojit të sigurimit janë si mëposhte:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Deme jete debitori	21,813,431	21,471,174
Deme Flexi-Plan	22,457,902	27,723,916
Deme jete ne grup me aksidente personale	10,607,217	10,566,342
Deme jete nxenes dhe studente	7,429	-
Deme jete dhe shendet studenti	-	26,194
Deme jete dhe shendet ne udhetim	-	596,968
Shpenzime trajtim demi	504,000	693,000
Deme jete ne pension	213,517	218,491
	<u>55,603,496</u>	<u>61,296,085</u>

22.2 Rezervat për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria ka 54 dëme të papaguara ende me një vlerë totale të RBNS prej 59,8 milion Leke (2019: 54,9 milion Leke dhe 41 dëme). Demet në protokollin e jetes së debitorit zënë pjesën kryesore në keto rezerva me një vlerë totale 49 milion Leke dhe 16 raste në numër. Nga keto 8 raste i përkasin periudhave deri në vitin 2017 dhe janë çeshtje në procese gjyqësore.

Jete dhe shendet flexi plan me peshe në rezervën e humbjeve me një vlerë 2.1 milion Leke me 11 raste në total. Jete në grup me aksidente është portofoli i dytë me peshe 4,3 Leke në rezervën e humbjeve me një vlerë 2.1 milion dhe ka 16 raste në total.

Portofolit e tjera si Jeta dhe Shendetit në Udhetim, Jeta e Studentit janë në total 11 raste demesh me vlerë 3.8 milion Leke.

Rezervat për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes sipas produkteve janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>Ndryshimi për periudhën</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Ndryshimi për periudhën</u>
Provizione dëme:				
- Debitori	58,989,883	12,349,605	46,640,277	16,034,081
- Jeta dhe Shendet Studenti	427,465	100,741	326,724	247,180
- Jeta dhe Shendetit në Udhetim	2,186,794	681,857	1,504,937	(1,255,854)
- Flexi Plan	2,943,437	1,299,270	1,644,167	957,052
- Jete dhe Aksident në Grup	2,667,012	(10,051,197)	12,718,209	(5,179,868)
- Nxenes dhe student	3,025,204	3,024,696	508	508
- Jeta me pension	1,578,923	(341,184)	1,920,107	(416,506)
	<u>71,818,718</u>	<u>7,063,788</u>	<u>64,754,929</u>	<u>10,386,593</u>
Të raportuara por jo të paguara (RBNS)	59,820,716	4,868,692	54,952,024	9,637,877
Të ndodhura por jo të raportuara (IBNR)	11,998,002	2,195,097	9,802,905	748,716
	<u>71,818,718</u>	<u>7,063,789</u>	<u>64,754,929</u>	<u>10,386,593</u>

23. REZERVA PËR PRIMET E PAFITUARA

Per llogaritjen e rezerves se primit te pafituar jane marre ne konsiderate kontratat per te gjitha linjat e biznesit te jetes te shitura deri ne 31.12.2019. Ne llogaritjen e primit te pafituar eshte perdorur metoda e diteve ekzakto mbi primin bruto te sigurimit, nuk jane konsideruar ne llogaritjet per rezerven e primit te pafituar policat e kthjera apo anuluar.

Ne produktin e sigurimit te Jetes se Debitorit, rezerva e primit eshte llogaritur duke perdorur metodat aktuariale per provigjonet matematike, duke konsideruar dhe tabelat e mortalitetit per cdo moshe. Nga llogaritjet rezulton qe niveli i provigjontit matematik ne 31 dhjetor 2020 te jete ne vleren e 116,133 mije Lek. Provigjioni i primeve të pafituara është detajura si mëposhtë:

	31 dhjetor 2020	Ndryshimi për periudhën	31 dhjetor 2019	Ndryshimi për periudhën
Jeta e debitorit	68,912,227	33,768	68,878,459	19,742,845
Jeta dhe shendet studentit	300,127	(101,718)	401,845	(348,706)
Jeta dhe shendetit ne udhetim	297,361	(892,259)	1,189,620	55,662
Jeta dhe shendetit – Flexi Plan	28,385,537	907,196	27,478,341	5,645,903
Jeta ne grup me aksident personal	18,097,565	385,345	17,712,220	(12,962,314)
Jeta per nxenes dhe student	65,962	(406,437)	472,399	(396,754)
TOTALI	116,058,779	(74,105)	116,132,884	11,736,636

23.1 Rezerva per riskun e paskaduar

Shoqeria nuk shet produkte me vlere kthimi ose investimi keshtu qe nuk llogarit rezerva te vecanta matematikore. Nese llogaritjet e Testimit te Mjaftueshmerise se Rezervave (“LAT TEST-it”) te pergjegjesive sipas produkteve paraqesin rezultate negativ Shoqeria llogarit dhe mban provigjontin e riskut te paskaduar. Aktualisht LAT Testi verifikoi nevojten per te llogaritur dhe mbajtur nje provizion vetem portofolin e jetes dhe shendetit ne udhetim ne vlere 89,158 Leke.

24. KAPITALI AKSIONAR

Me vendimin nr. 53, datë 22.05.2017 "Për miratimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e sigurimit "INSIG JETË" sh.a. të Bordit të AMF, ndryshon struktura e zoterimit të aksioneve me këto të dhëna:

- z. Samir Mane zotërues i 45 % të aksioneve;
- z. Shefqet Kastrati zotërues i 45 % të aksioneve;
- Shoqëria jo - jetë "EUROSIG" sh.a. zotërues i 10 % të aksioneve.

Më 26 maj 2020 është firmosur marrëveshja për revokimin e kontratës së shitjes së aksioneve të Insig Jetes date 10.05.2017.

AMF me anë të vendimit numër 117 të Bordit, datë 31/08/2020, vendosi miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën:

- 100% të aksionari Shoqëria jo - jetë "EUROSIG" sh.a. në shoqërinë e sigurimit të Jetës "Insig Jetë" sh.a..

Struktura e kapitalit paraqitet si mëposhte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shoqëria e sigurimit jo-jete Eurosiga sha	100%	10%
Z. Samir Mane	0%	45%
Z. Shefqet Kastrati	0%	45%
TOTALI	<u>100%</u>	<u>100%</u>

Aksionari I vetem Eurosiga sha me ane të vendimit nr 10 dhe 11 date 23 dhjetor 2020 ka aprovuar raportin e ekspertit kontabel për rritjen e kapitalit aksionar në natyrë me pasuri të paluajtshme truall si dhe aprovon rëndryshimet që vijnë si pasoje të rritjes së kapitalit aksionar nga 370.000.000 Leke në 590.000.000 Leke. Kontributi është shlyer në natyrë me toke truall, me sipërfaqe 5.443.7 m² e ndodhur në Tiranë me një vlerë tregu 220,00,000 Leke. Arovimi I rritjes së kapitalit nga AMF është bërë me ane të vendimit nr 58 date 26.03.2021. Veprimet për kalimin e pronësive pranë Zyres së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) kanë nisur me date 31.03.2021.

Kapitali themeltar I shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 i cili zotërohet nga aksionaret e shoqërisë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri I aksioneve	616,000	616,000
Vlera nominale	957.79	600.65
	<u>590,000,000</u>	<u>370,000,000</u>

Kapitali themeltar i shoqërisë me 31 dhjetor 2020 në vlerën 590,000,000 Leke përbëhet nga:

- 370,000,000 Leke kapital themeltar I paguar

- 220,000,000 Leke kapital kontribut në natyrë pasuri e paluajtshme - truall

Kapital themeltar, është në përputhje me nenin 17, dhe nenin 98 të ligjit Nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndermjetësimit në sigurime dhe risigurime" i cili kërkon që shoqëria duhet të ketë kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, jo më të vogël se vlerat e përcaktuara të fondit të garancisë, të parashikuara në nenin 98 të këtij ligji.

24. KAPITALI AKSIONAR (vazhdim)

Shoqëria me 01.01.2020 ka bere rivleresimin e aktiveve afatgjata materiale kategoria ndertesa ne perputhje me SNK 16 duke kontraktuar nje ekspert rivleresimi.

Ne tabelen me poshte paraitet levizja e rezerves se rivleresimit:

	Rezerva e rivleresimit Ndertesa	Total
Gjendja me 31 dhjetor 2019	-	-
Shtesa nga rivleresimi	5,612,885	5,612,885
Pakesim nga shitja e asetëve	(2,315,788)	(2,315,788)
Gjendja me 31 dhjetor 2020	3,297,097	3,297,097

Fitimet e pashperndara me 31 dhjetor 2020 paraqiten ne vleren 83,940,912 Leke (2019: 59,387,954 Leke)

25. PRIME TË SHKRUARA BRUTO

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Sigurimi i jetes se debitorit	114,557,846	116,820,694
Sigurimi i jetes ne grup me aksidente personale	25,947,352	42,653,973
Sigurimi i jetes dhe shendetit - Flexi Plan	53,064,339	47,762,980
Sigurimi i jetes dhe shendetit ne udhetim	5,384,450	16,873,400
Sigurimi i jetes dhe shendetit te studentit	630,654	937,500
Sigurimi i jetes per nxenes dhe student	231,500	921,300
Totali	199,816,141	225,969,847

26. PRIME TË SHKRUARA ÇEDUAR RISIGURUESIT

Primet e ceduara risiguruesit janë në shumën 20,403 mije Lek të cilat lidhen me produktet e sigurimit të Jetës për Hua dhe jete ne grup me aksidente personale, me risiguruesit Scor Global Life dhe Sia UlysseRE.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Prime te ceduara ne risigurim-Jete debitori	19,162,137	15,227,034
Prime te ceduara ne risigurim-Jete ne grup me aksidente peronale	1,240,500	1,221,100
	20,402,637	16,448,134

27. TË ARDHURAT NGA INVESTIMET

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga interesat Bono Thesari	2,319,994	3,251,978
Të ardhura nga interesat e depozitave	7,952,748	5,055,433
Të ardhura nga interesat e llogarive rrjedhëse	55	692
Totali	10,272,797	8,308,103
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi qira financiare	-15,193	-
Shpenzime interesi qira ifrs16	-486,744	-721,363
Shpenzime interesi	-	-61,119
Totali	-501,937	-782,482
Fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit		
Fitim nga kursi i këmbimit	4,874,403	931,458
Humbja nga kursi i këmbimit	-4,160,953	-1,435,959
Totali	713,450	-504,501
Të ardhura financiare, neto	10,484,310	7,021,120

28. KOSTOT E MARRJES NË SIGURIM

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Komisione paleve te treat	52,034,073	51,411,102
Komisione personeli	466,863	1,000,850
Shpenzime te marrjes ne sigurim	655,260	1,131,155
Shpenzime publiciteti	664,371	438,565
Shpenzime për policat	411,213	915,454
	54,231,780	54,897,127

Kostot direkte te marrjes ne sigurim ndahen per cdo produkt sigurimi bazuar ne shpezimet faktike qe i alokohen ketyre produkteve. Shpenzimet e publicitetit dhe reklames jane shpenzime faktike te kryera per produktet specifike. Kostot direkte te marrjes në sigurim si dhe shpenzimet e publicitetit sipas çdo produkti për periudhën deri më 31 dhjetor 2020 detajohen më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Sigurimi i jetes se debitorit	35,726,111	27,299,745
Sigurimi i jetes dhe shendetit te studentit	135,841	228,422
Sigurimi i jetes dhe shendetit ne udhetim	3,636,893	10,535,745
Sigurimi i jetes dhe shendetit - Flexi Plan	9,618,936	7,893,934
Sigurimi i jetes ne grup me aksidente personale	5,044,850	8,624,683
Sigurimi i jetes per nxenes dhe student	69,149	314,598
	54,231,780	54,897,127

29. SHPENZIMET E PERSONELIT

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime personeli		
- Paga	28,407,959	28,542,964
- Shpërblim personeli	298,998	1,516,119
- Kontribut i sigurimeve Shoqërore	3,697,826	3,736,495
-Trajtim Personeli	48,000	-
	<u>32,452,783</u>	<u>33,795,578</u>

30. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Kontribute ndaj AMF	2,877,096	3,138,607
Sherbime auditimi	1,687,287	1,193,346
Tarifa , tatime te tjera dhe gjoba	1,484,013	1,152,388
Shpenzime qiraje	869,632	1,016,477
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	692,223	887,674
Ujë, energji dhe komunikim	430,233	614,724
Publicitet dhe reklama	2,566,451	525,459
Shpenzime konsulence	657,282	473,799
Shpenzime për pritje dhe dhurata	-	443,450
Shpenzime per karburant	344,300	408,400
Shpenzime per komisione bankare	295,270	322,672
Mirembajtje dhe riparime	537,034	239,060
Shpenzime per ruajtje dhe siguri	113,636	129,102
Zhvleresim per llogari te arketueshme	233,681	-
Shpenzime per nxjerrje jashte perdorimit	2,789,119	-
Shpenzime administrative te tjera	5,771,178	3,638,711
	<u>21,348,435</u>	<u>14,183,869</u>

31. TË ARDHURA NGA KOMISIONE DHE TE ARDHURA TE TJERA

	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga komisioni për Jetën për hua nga Risiguruesi	4,282,564	3,325,877
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	120,542	-
Të ndryshme	80,159	-
Të ardhura të tjera nga veprimtaria siguroese	291,600	-
	<u>4,774,865</u>	<u>3,325,877</u>

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet janë të gjeneruara nga kontratat e risigurimit dhe bashkesigurimit.

32. SHPENZIME PËR TATIMIN

Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt i interpretimeve nga autoritete tatimore. Shpenzimet e pazbritshme për qëllim tatimi paraqesin shpenzime të cilat nuk janë të mbështetura me dokumentacion të përshtatshëm ose shpenzime të cilat nuk konsiderohen të klasifikueshme për qëllime fiskale.

Shpenzimet e pazbritshme janë të detajuara si mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Gjoha dhe penalitete	-	29,912
Shpenzime të pambështetura në dokumentacion të pershtatshëm tatimor	187,407	525,140
Tekalim I shpenzimeve të amortizimit fiskal	270,995	-
Nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të qendrueshme	2,789,119	-
Zhvlerësim i të arketueshmeve	233,681	-
Tatim 5% rivlerësim asetesh	280,644	-
	3,761,846	555,052

Analiza e llogarisë tatim fitimin për vitin 2020 paraqitet si mëposhtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrim më 1 janar	(2,424,506)	787,073
Pagesa deri më 31 dhjetor	(1,634,895)	(7,607,581)
Kompenzime të tatimit	(435,698)	-
Shpenzimi i tatimit për vitin	4,609,158	4,353,724
Aktiv i shtyre tatimor	6,220	42,279
Detyrim më 31 dhjetor	120,279	(2,424,506)

Parapagimet për tatim fitimin për vitin janë netuar kundrejt detyrimit për tatimin fitimin e vitit korrent paraqitur në zërin "Parapagim i tatim fitimit" si dhe kundrejt kompensimit të tatimit në burim me kestet e tatim fitimit për 2020

Në bazë të ligjit lokal për kontabilitetin, duke filluar që nga 1 janari 2008 Shoqëritë e Sigurimit duhet të raportojnë sipas SNRF. Gjithashtu, Ligji Nr. 10364 më datë 16.12.2010 jep disa amendime (efektive më 24 janar 2011). Në bazë të këtyre amendimeve, detyrimet e sigurimit që ngarkohen nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me SNRF duhet të konsiderohen shpenzime të zbritshme.

Llogaritja e tatimit vjetor është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi/Humbja para tatimit	26,965,872	28,469,773
Shpenzime të pazbritshme për qëllime tatimore	3,761,846	555,052
Fitimi i taksueshëm për vitin	30,727,718	29,024,825
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin aktual 15%	4,609,158	4,353,724

Në përputhje me rregulloret tatimore vendore norma e aplikueshme për tatimin 2020 është 15% (2019:15%). Deklarimet tatimore plotësohen çdo vit. Gjate vitit 2020, Shoqëria ka parapaguar tatim fitim në vlerën 1,634,895 Leke dhe ka kompensuar tatimin në burim me kestet e parapaguara të tatim fitimit në vlerën 435,698 Leke.

32. ANGAZHIME DHE DETYRIME**Çështje ligjore**

Në aktivitetin normal të biznesit Shoqërisë i raportohen çështje ligjorë të cilat janë të lidhura me sigurimin. Gjithsej Shoqëria ka 12 raste ne procese gjyqesore nga te cilat 2 jane ne Gjykatën e Lartë, 2 jane ne Gjykatën e Apelit dhe 8 raste ne Gjykatën e Shkalles se Pare.

Demet ne Gjykatën Lartë i takojne periudhes 2010-2014 dhe jane ne portofolin e jetes se Debitorit me nje vlere totale 6,2 milion Leke.

Rastet e demeve ne Gjykatën e Apelit i takojne perseri portofolit te sigurimit te Jetes se Debitorit me ngjarje te ndodhura ne vitin 2014-2015 dhe me vlere 2,7 milion Leke (te dyja keto ceshtje jane fituar nga kompania ne shkallen e pare)

Rastet ne Gjykatën e Shkalles se Pare i takojne portofolit te Jetes se Debitorit/ Shendetit ne Udhetim dhe Sigurimit te Jetes ne Grup. Vera totale e tyre eshte rreth 4.2 milion Leke.

Shoqëria nuk ka ceshte te tjera ne gjykate pervec atyre te lidhura me detyrimet e demeve.

Detyrime të kushtezuara

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka ndonjë detyrim të kushtëzuar që rezulton prej aktivitetit të saj.

Angazhimet kontraktuale me klientët

Per produktin “Jetë debitori” Shoqëria hyn në marrëdhënie afatgjata me klientët e Bankave të nivelit të dytë për mbulimin e rrezikut të vdekshmërisë të debitorëve gjatë afatit të huamarrjeve. Siç detajohet dhe në shënimin 3.c) të pasqyrave financiare, Shoqëria njih primin e shkruar bruto vjetor që ajo lëshon në periudhat raportuese. Pjesa e mbetur e primit të shkruar që do njihet për periudhat e ardhshme është angazhim i pritshëm nga Shoqëria, përveçse në rastet kur kontratat anulohen apo mbyllen përpara afatit të paracaktuar.

Primi i shkruar i pritshëm për tu arketuar në vitet që vijnë nga policat afatgjata te sigurimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Jo më shumë se 1 vit	199,692,641	225,771,316
Më shumë se 1 vit por më pak se 5 vjet	123,500	198,531
Më shumë se 5 vjet	-	-
	199,816,141	225,969,847

Angazhimet për qiranë

Shoqëria ka hyrë në angazhime qiraje operative për degë e saj Elbasan per nje periudhe 1 vecare. Kjo qira nuk i ploteson kushtet per klasifikimin e qirave sipas ifrs 16. Më 31 dhjetor 2020, angazhimet e pagueshme për qiranë operative brenda një viti përlllogariten në 47 mijë lekë (2019: 47 mijë lekë).

33. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse një palë ka mundësinë që të kontrollojë ose që të ketë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë.

Një njësi ekonomike që përdor një kompani menaxhimi (një njësi ekonomike që ofron shërbime të rëndësishme të menaxhimit të personelit) është e nevojshme që të paraqesë shpenzimet e bëra për shërbimet e menaxhimit. Shoqëria nuk ka marrë ndonjë shërbim të menaxhimit nga subjektet e tjera.

Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura gjatë aktivitetit të zakonshem të biznesit. Këto transaksione janë kryer me terma tregtare dhe në normat e tregut. Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivet e sigurimit	-	4,058,184
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	-	4,058,184
Primet e shkruara bruto	-	18,098,452
Sigurimi i Jetës	-	18,098,452
Shpenzimet e sigurimit	-	12,864,216
Dëme të paguara	-	12,864,216
Të ardhura të tjera	-	-
Shërbime ndaj palëve të lidhura	-	-
Shpenzimet administrative	405,122	408,400
Shpenzime Qiraje	360,000	-
Shpenzime Sigurimi	45,122	-
Shpenzime karburant	-	408,400
	(405,122)	4,058,184
Arketimie dhe pagesa kunderjt paleve te lidhura		
Te drejta ndaj paleve te lidhura ne fillim te vitit	17,115,689	19,362,957
Arkëtime nga pale te lidhura	15,385,437	2,247,268
Pagesa ndaj pale te lidhura	-	-
Gjendja ne fund te vitit	1,730,252	17,115,689

Kompensimi total për drejtuesit kryesorë të Shoqërisë, të përfshira në shpenzimet administrative si shpenzime personeli për fundin e vitit 31 dhjetor 2020 është 6,573,030 Lekë (2019: 6,796,637 Lekë).

34. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare.

INSIG JETE sh.a.

Skedule suplementare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

SKEDULET SUPLEMENTARE

1. AKTIVET NË MBULIMIN E PROVIGJIONEVE TEKNIKE

Në përputhje me Rregulloren për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve miratuara me vendimin e bordit nr. 200, datë 27 dhjetor 2016, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë jo më shumë se normat e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve për të mbuluar rezervën teknike dhe matematike:

31 dhjetor 2020	150.24%		Aktivet në mbulimin e provigjioneve teknike
	Kufiri i investimeve në raport me provigjonet	Kufiri i investimit në vlerë sipas rregullores	
Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara	3.50%	6,575,712	3,054,673.95
Toka dhe Ndertesa	30%	56,363,249	56,363,249.10
Aksione dhe investime në tregun e parasë	5%	9,393,875	-
Sig. të arkëtueshme (% mbi rez.e primit të pafitur)	20%	23,211,756	15,035,106
Aktivët e risigurimit	100%	187,877,497	13,120,615.00
Hua të pasiguruara	5%	9,393,875	-
Mjete monetare në arkë dhe llog.rrjedhëse	3%	5,636,325	5,636,324.91
Letra me vlerë të qeverisë (Bono Thesari)	70%	131,514,248	-
Hua të hipotekuara	15%	28,181,625	-
Depozita me afat	100%	187,877,497	169,002,300.00
Shpenzime te shtyra te marrjes ne sigurm	15%	17,408,817	17,408,816.85
Parapagime dhe të ardhura të llogaritura	5%	9,393,875	2,653,258.00
			282,274,344

2. LLOGARITJA E MJAFTUESHMËRISE SË KAPITALIT

Në përputhje me Nenet 75-80 të Ligjit Nr 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” Shoqëria e Sigurimit llogarit mjaftueshmërinë e kapitalit që përbën dhe aftësinë paguese të saj. Aftësia paguese përbëhet nga aktivet e shoqërisë së sigurimit të lira nga çdo përgjegjësi e parashikueshme, duke zbritur prej tyre elementët e zbritshëm sipas Rregullores së Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare nr. 87 datë 27 qershor 2016.

Aftësia paguese më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020
A: Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit)	677,357,553
B: Elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit sipas nenit 79 të ligjit 52/2014	230,855,160
-Aktive të ndryshme nga Toka dhe Ndertesa	244,720
-Toka dhe ndertesa	213,267,466
-Aktive të patrupezuara	2,515,047
- Gjendja e inventarit	493,620
- Garanci për kontrata sigurimi	-
- Debitorë policembajtës mbi 90 ditë	8,465,501
- Llogari të arktueshme nga palet e lidhura	1,730,252
-Tatime të parapaguara	1,246,775
-Aktiv i shtyre tatimor	48,499
-Depozita të lena si kolateral	2,843,280
- Te tjera të arketueshme	-
C: Kapitali Aftësia paguese A-B	446,502,393
D: Kufiri minimal i aftësisë paguese sipas pikës 3 të nenit 80 të ligjit 52/2014	92,962,030
E: Fondi i Garancisë sipas nenit 81 të ligjit 52/2014	370,000,000
F: Niveli i kërkuar i aftësisë paguese sipas pikës 2 të nenit 80 të ligjit 52/2014	370,000,000
Mbi (+) nën (-) nivelin e kërkuar të aftësisë paguese (C-F)	76,502,393
Mjaftueshmëria e kapitalit	76,502,393